

KUVENDI

Blushi: Roshi më kërcënoi! Ja fyretet që s'u dëgjuan me Ballën

► F 6

ANALIZË

Zëvendësimi i gabuar i termit "togfjalësh" me "grup emëror"

► F 20

NGA ERGET ÇENOLLI

TITUJT E PRONISISE

Shtyhen deri në fund 2017 afatet për tokat bujqësore

► F 12

KESTI I PESTE

530 TE PERNDJEKURIT QË DUHET TE DOREZOJNE DOKUMENTACIONIN

Përfituesit e dëmshpërblimit duhet t'i paraqesin pranë Ministrisë së Financave

► F 16



Opinion

NGA JONIADA KOÇI



Kur shteti lë jetim të ardhmen e tij!

Të lutem, Zot, më lër ta rris vetë vogëlushin tim. Këtë lutje i drejtoj disa herë në ditë Perëndisë. Teksa ushqëja tim bir me gj, bashkëshorti më informoi se në Shtëpinë e Fëmijës në Shkodër kishte ndodhur mënyryta e rradhës: ishin abuzuar, edhe seksualisht, disa vajza të mitura.

vijon në faqen 15

[SHQIPTARJA.COM]

ÇMIMI 30 LEKË | VITI VI - NR. 118 | E PREMTE, 20-05-2016 | www.shqiptarja.com

LETRA E POLICISE ITALIANE: PAJISJA JONE NUK PERGJON PERGJIMET, BIE 'KESHTJELLA' E BERISHES DHE NISHANIT

Shkresa e Pansa për Lllallën dy ditë para zëvendësimit. Ku janë 375 zyrtarët e përgjuar? Dy përgënjeshtime brenda 24 orëve për Sali Berishën. Bie kredibilitetii Likës dhe Nishanit


► FAQE 2-3

Dokumenti

► F 4

BLLOFI I DYTE I BERISHES, FALSIFIKON EUROPOL

Operacioni antidrogë, fshin emrin e Shqipërisë si partner me Greqinë e Belgjikën



INVESTIGIMI
SI SUZANA GUXHOLLI BEHET PRONARE E SHOQERISE 'PARTIZANI'
Në ditët e fundit si këshilltore e Berishës rregjistroi aksionet
NGA ELTON QYNO ► F 11

SKANDALI SEKSUAL ► F 13
DREJTORI I KULTURES: SHUKRIU NE TRE MUAJ ME SOLLI KATER FEMRA

HYSNI KAPO MISTERI, 40 VITE KONSPIRACION MBI VDEKJEN E TU
Dosja mjekësore që erdhi nga Parisi u mbyll në arkiv
NGA YLLI POLOVINA ► F 18-19

Policia italiane: Pajisja në zotërimin tonë, nuk përgjoi

Drejtori i Policisë italiane Alessandro Panza hedh poshtë përgjimet e pretenduara

ADRIATIK DOÇI
TIRANË

Policia italiane i ka dhënë fund dhe debatit mbi përgjimet në Shqipëri. Në një letër që drejtori i saj Alessandro Panza i çon kryeprokurorin Adriatik Lallën, përmes Ambasadës italiane, konfirmon se pajisja nuk është përdorur për asnjë lloj përgjimi dhe se ka qenë gjithmonë në zotërim të palës italiane vetëm për qëllime trajnimit. Panza e konsideron pajisjen një aset stërvitor, e cila nuk mund të zhvillojë asnjë aktivitet gjurmues. "Bazuar në marrëveshjen e firmosur në 2007 midis Shqipërisë dhe Italisë, më 11 mars të 2016 janë nisur në Tiranë dy operatorë të specializuar nga

forcat e policisë italiane me detyrë zhvillim aktiviteti për trajnimin e policisë lokale. Personeli italian merr me vete, për aktivitet stërvitor të cituara, një autoveturë me në ekuipazh një aparat të quajtur "IMSCATCHER", modeli Vortex i prodhuar nga kompania Ercom, e instaluar në brendësi të makinës. Ky aset stërvitor rezultoi i konfiguruar në mënyrë të tillë që mos të ketë mundësi të zhvillojë asnjë aktivitet gjurmues, as trafiku zonor, as tekst mesazhe. Ky konfigurim, i cili nuk është i modifikueshëm nga operatori, nuk lejon as gjurmimin e trafikut të datave", thuhet në letërën e drejtorit të Policisë Italiane.

PAJISJA

Në këtë letër, për herë të parë, hidhet dritë mbi mënyrën e përdorimit dhe vendqëndrimin të pajisjes. Policia italiane konfirmon me përgjegjësi të plotë se kjo pajisje nuk ka qëndruar për asnjë minutë në duart e kolegëve të tyre shqiptarë. "Aparatura trajnuese ka qenë gjithmonë në zotërim të operatorëve italianë dhe e ruajtur, kur kjo nuk përfshihet në aktivitetet formuese dhe trajnuese, në zyrën ndërlidhëse italiane në Shqipëri, në brendësi të Ambasadës Italiane në Tiranë", thuhet në letër. Sipas letrës së kryepolicit italian, Panza, me këtë pajisje janë trajnuar 5 operatorë të policisë shqiptare, me aktivitet të zhvilluar në qytetet e Tiranës, Elbasanit dhe Vlorës, dhe se sipas tij, aktiviteti trajnues nuk do të mund të kishte mundësi të kryente shkelje të asnjë lloji, nga personeli i policisë italiane i punësuar. Kjo përgjigje e mbërritur tre ditë më parë në Shqipëri dhe dërguar enjten në Prokurorinë e Tiranës, hedh poshtë pretendimet e deritanishme, jo vetëm të opozitës, por dhe Shërbimit Informativ Shtetëror se pikërisht kjo pajisje e Interforcës ka kryer përgjime të jashtëligjshme.

IMUNITETI

Drejtori i Policisë Italiane i kujton Prokurorisë Shqiptare se marrëveshjes mes dy shteteve, e nënshkruar nga Sali Berisha dhe Bujar Nishani në vitin 2007, përjashton palën italiane nga përgjegjësit penale dhe civile në lidhje me këtë hetim. Shqiptarja.com, publikoi disa ditë më parë, pjesë nga marrëveshja e 2007, mes qeverisë shqiptare dhe asaj italiane. Marrëveshja e qeverisë "Berisha" ka pajisur me imunitet Personelin e Zyrës Ndërlidhëse

ALESSANDRO PANZA

"Ky aset stërvitor rezultoi i konfiguruar në mënyrë të tillë që mos të ketë mundësi të zhvillojë asnjë aktivitet gjurmues, as trafiku zonor, as tekst mesazhe. Ky konfigurim, nuk lejon as gjurmimin e trafikut të datave".



Italiane Interforze në Shqipëri. Kjo njësi nuk mund të ndiqet penalisht, nuk mund t'i kërkohet logari si dhe nuk mund t'i kontrollohen bagazhet. Sipas marrëveshjes, personeli i Zyrës Ndërlidhëse Italiane Interforze gëzon imunitet nga juridiksioni civil, penal dhe administrativ për veprimet e kryera gjatë ushtrimit të funksioneve të tij.

MARRËVESHJA

Shkëmbimi i eksperiencave dhe trajnimit i burimeve njerëzore të Policisë së Shtetit nga Interforca Italiane, buron nga zbatimi i ligjit nr. 9799, datë 10.9.2007, për marrëveshjen e bashkëpunimit ndërmjet qeverisë shqiptare dhe asaj italiane, në luftën kundër kriminalitetit. Kjo marrëveshje është firmosur nga vetë Sali Berisha, asokohe kryeministër. Po ashtu, marrëveshja është zbatuar nga ish-ministri i Brendshëm, Bujar Nishani dhe ish-zëvendësdrejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit, Agron Kuliçaj, i cili de fakto ka luajtur rolin jo vetëm të drejtorit të policisë, por edhe të ministrit të Brendshëm. Për zbatimin e marrëveshjes, palët kanë rënë dakord që të caktonin si organe kompetente ministritë të brendshme, drejtoritë e përgjithshme dhe departamentet e sigurisë publike respektive. Ndërkaq, në modalitetet e marrëveshjes përfshihet asistenca teknike, shkëmbimi i përvojave dhe trajnimet, duke përfshirë edhe pajisjet e përgjimit, të cilat sipas këtij ligji nuk mund të kontrollohen dhe hetohen nga autoritetet shqiptare.

Visho Ajazi Lika për përgjimet


"Dy muaj të shkuara ne morëm informacion se një pajisje e teknologjisë së lartë kishte ardhur në Shqipëri dhe ishte vendosur në Vlorë "IMCI Catcher". Se çfarë është kjo pajisje të gjithë mund të njihen me të në internet. Ajo që ishte problematike, ishte se nuk ishte deklaruar që kishte hyrë brenda. I shqetësuar se një pajisje e tillë mund të përdorej edhe për veprimtari të paligjshme, mora kontakt me kryeprokurorin. Të informoheshin institucionet e shtetit për një pajisje që mund të cenonte sigurinë kombëtare. Lidhur me atë që është thënë në media. Nga këtej do merrnim informacionet e duhura nga institucioni që e kishte. Nuk kemi asnjë informacion tjetër se kush është përgjuar. Shërbimi është jashtë kësaj".

Bujar Nishani për përgjimet

"Qeveria të ndalojë përpjekjet për mashtrimin e opinionit publik në lidhje me marrëveshjet e bashkëpunimit me shtetin italian. Marrëveshja e bashkëpunimit midis shtetit shqiptar dhe atij italian në luftën kundër krimit të organizuar nuk ka asnjë lidhje me veprimet antiligjore dhe të dënueshme të përdorimit të mjeteve ilegale dhe të paligjshme nga Policia shqiptare. Presidenti i Republikës dënon dhe distancohet nga tentativa e papërgjegjshme e Qeverisë për të ngatërruar bashkëpunimin dhe partneritetin e shkëlqyer midis Shqipërisë dhe Italisë në luftën kundër krimit të organizuar, me veprime ilegale dhe të paligjshme të segmenteve të caktuara të Ministrisë së Brendshme në Shqipëri".

Sali Berisha për përgjimet

"Ja disa nga personalitetet shtetërore dhe politike nga lista e 375 të përgjuarve nga institucionet shtetërore, partitë politike, biznesi, media dhe bota artistike të përgjuar prej 6 muajsh në kundërshtim me ligjin dhe Kushtetutën nga manjaku Edvin Shullazli Bujar Nishani, Florian Nuri, Ilir Meta, Luzlim Basha, Bashkim Dede, Adriatik Lallë, Ylli Manjani, Edmond Panariti, Erion Veliaj, Visho Ajazi, Bujar Leskaj, Iglj Totozani, Genti Sejko, Gramoz Ruçi dhe deputetet Pandeli Majko, Anastas Angjeli, Esmeralda Shkaj, Vasilika Hysi. Burimet dixhitale bëjnë me dije se në listën e të përgjuarve janë ambasadorët e vendeve të mëdha perëndimore dhe shefat e shërbimeve perëndimore, shefat e misioneve të institucioneve ndërkombëtare të akredituar në Tiranë".



Aparatura trajnuese

"Aparatura trajnuese ka qenë gjithmonë në zotërim të operatorëve italianë dhe e ruajtur, kur kjo nuk përfshihet në aktivitetet formuese dhe trajnuese, në zyrën ndërlidhëse italiane në Shqipëri, në brendësi të Ambasadës Italiane në Tiranë".

Drjetori italian

Shkresa e Panza për Lallën dy ditë para zëvendësimit

Sali Berisha dhe rrethi i tij politiko-mediatic e kanë përjetuar me nervozizëm letërën e kreut të Policisë Italiane, Alessandro Panza, mesditën e djeshme, letër e cila fashiti zhurmën rreth përgjimeve të paligjshme në Shqipëri. Mbrëmjen e djeshme pati një përpjekje për ta vënë në dyshim letërën. U hodh një tezë, sipas së cilës Panza e kishte firmosur letërën pasi është larguar nga detyra. Po si qëndron e vërteta? Alessandro Panza, me vendim të datës 29 Prill të Këshillit të Ministrave të Italisë është emëruar shef i shërbimeve sekrete, por ka mbetur në detyrë deri në datë 19 Maj. Pasuesi i tij në këtë post Franco Gabrielli ka marrë detyrën zyrtarisht në datën 19 Maj. Ndërkaq, në 17 Maj është firmosur letra për kryeprokurorin Adriatik Lallë. Pra, Panza ka firmosur letërën për Lallën dy ditë para se të zëvendësohej.



Alessandro Panza

VULA

Sipas informacioneve të "Shqiptarja.com" dikush në Prokurorinë e Përgjithshme ka vënë në dyshim autenticitetin e letrës së kreut të Policisë Italiane, Alessandro Panza. Janë ngritur pretendime për çështjen e vulës në letër. Por, në juridiksionin diplomatik, letrat thjeshtë firmosen nga autoritetet dhe nuk vulojnë. Letrat vulojnë nga ambasada e shtetit përkatës në vendin ku adresohet. Dhe e njëjta praktikë është ndjekur edhe në rastin konkret, ku letra është firmosur nga ambasadori i Italisë në Tiranë, Alberto Cutillo.

Bllofi i dytë i Berishës, falsifikon dokumentin e EUROPOL-it

Operacioni antidrogë, fshin emrin e Shqipërisë si partner me Greqinë e Belgjikën

Për herë të dytë brenda pak ditësh, Sali Berisha ka bërë një tjetër bllof, për të mos thënë një falsifikim me qëllim dezinformimin dhe keqinformimin e publikut për arsye politike. Ish kryeministri Sali Berisha ka falsifikuar dokumentin e EUROPOL për operacionin antidrogë të datës 13 maj, i shtrirë në Greqi dhe Belgjikë. Në dokumentin e publikuar nga Berisha në Facebook Shqipëria nuk përmendet si vend që ka ndihmuar operacionin. Ndërsa krejt e kundërta paraqitet në faqen zyrtare të EUROPOL ku Shqipëria renditet krahas Bel-

gjikës dhe Greqisë si vend që ka mbështetur hetimet dhe operacionin antidrogë gjatë arrestimeve të 11 qytetarëve grekë e 6 shqiptarë. Nga ky operacion u kapën 698 kg hashash në Greqi dhe 96.5 kg në Belgjikë. Për këtë çështje debatuan gjatë seancës së Kuvendit kryeministri Edi Rama dhe paraardhësi i tij, Sali Berisha. "Nuk është as e re, as e fundit dhe shumë e vjetër, e vërteta që ti je një gënjeshtar patologjik. Ja ku e ke deklaruar në EUROPOL-it dhe në anglisht. Por mund ta google-osh, meqenëse nuk më sheh dot në sy. Lexoje! Por edhe sesi lexon, të kam parë vetë, kur unë dhe ti kemi

dalë bashkë këtu në këtë follore dhe t'i shtojë e hiqje mbi tekstin si mbas nevojave të partisë. Kjo është deklarata e EUROPOL-it dhe thotë: "Në 9 maj 2016, 17 individë, 11 grekë dhe 6 shqiptarë nga një rrjet kriminal i organizuar, i përfshirë në një trafik në shkallë të gjerë, u arrestuan në një operacion të koordinuar të agjencive ligjzbatuese, të udhëhequr nga Greqia dhe të mbështetur nga Shqipëria Belgjika dhe EUROPOL-i." është shprehur Rama. Në kohën që kryeministri Rama mbante fjalën në Kuvend dhe i tregonte dokumentin sipas tij të printuar direkt nga EUROPOL-i ish kryeministri Berisha mohonte nga vendi. "Po i mëson keq edhe kopjet e tua. Originali je vetëm ti, por në duar ke vetëm produkte të falsifikuara. Unë mbaj përgjegjësi të plotë për këtë. Deklaratën e ke të printuar direkt nga uebsite i EUROPOL-it. Besoj që me të mbaruar prokuroria, hetimin për mjetin e përgjimit, përsëri në gjuhë të huaj do të lexosh të vërtetën. Të tjerët që na dëgjojnë,



ndërkohë e verifikojnë vetë këtë që thashë. Nuk ka asgjë origjinale në duart e Salut. Është vetëm Saliu origjinali, gjithçka tjetër është produkt i falsifikuar dhe për këtë, e përsëris, jam dëshmitar, pasi kemi qenë të dy këtu dhe kam lexuar bashkë me ty të njëj-

tin tekst dhe të pashë sesi e lexon. Gjithsesi ka të tretë që gjykojnë dhe kjo është shumë e thjeshtë, mjafton të shkojnë në uebsite-n e EUROPOL-it dhe të kuptojnë se kush thotë të vërtetën dhe kush gënjen. Nuk është vetëm kjo, është më shumë se kaq. Në çdo



Rama pyet përsëri Berishën: Sali do e votosh reformën?

Kryeministri: "Keni angazhuar Nishanin që të mbrojtë gjykatësit e '17 katëshit'"

Kryeministri Rama i ka përsëritur edhe një herë pyetjen e javës së shkruar paraardhësit të tij duke e akuzuar se po pengon reformën në drejtësi. "Por unë kam pyetjen e mërzitshme: Reformën në drejtësi, Sali, do ta lejoj apo nuk do ta Partinë Demokratike ta votojë? Dhe mos shiko çfarë të shkruan qytetari dixhital, se ia fute këtë mikrob edhe të tjerëve, që rrinë me qytetarin dixhital në xhep dhe vijnë e nxjerrin në parlament. Më shiko në sy dhe më thuaj, përse nuk thua asnjë fjalë për reformën në drejtësi dhe përse Partia Demokratike nuk është në tryezën e komi-

sionit, për të votuar draftin e miratuar nga Komisioni i Venecias?" tha Rama. Kryeministri shtoi se kjo pyetje është retorike dhe akuzoi gjithashtu PD se ka përdorur dhe angazhuar presidentin Nishanin për të mbrojtur trupën gjyqësore të pallatit 17 katësh. "Mjafton të shikosh se çfarë ndodh në gjykatë me atë malin e betonit, që u dha leja nga kryetari në detyrë i partisë tënde, për të kuptuar se pse ti i pari, personalisht, je krejtësisht i pa interesuar që gjyqtarët dhe prokurorët në këtë vend të kalojnë në skanerin e vetingut dhe të përgjigjen një për një, sipas normave të përcaktuara nga projekti i reformës, për të kaluarën e tyre, për vendimet, pasurinë dhe aftësinë e tyre. Si mund ta pranosh këtë, kur ke nxitur, mbështetur dhe mban në këmbë, sot e gjithë ditën, duke penguar reformën në drejtësi, një sistem të korruptuar që bën shërbime për ty, personalisht, për njerëzit e tu, personalisht, për tarafin tënd, personalisht!" tha Rama. Ai shtoi se gjykata është e kapur, dhe presidenti është po ashtu i përfshirë. "Një turp i pashoq! Një gjykatë e kapur me presh në duar, që refuzon të zbatojë



→ GJYKATA

Një turp i pashoq! Një gjykatë e kapur me presh në duar, që refuzon të zbatojë më minimalen, të marrë në konsideratë konfliktin e interesit dhe të krijojë trupën për të gjykuar mbi turpin më të pashembullt

më minimalen, të marrë në konsideratë konfliktin e interesit dhe të krijojë trupën për të gjykuar mbi turpin

më të pashembullt që në historinë e bashkisë së Tiranës, një kryetar bashkie ka guxuar të bëjë, një mal betoni mbi digën e liqenit, që kërcënon jo vetëm parkun, por jetën e një lagjeje të tërë dhe që është konsideruar i rrezikshëm nga një komitet shtetëror specialistësh. Edhe sot, kur gjykata kishte vendosur që me forcë të merrte vendim, u detyrua përsëri të tërhiqet, sepse një tjetër gjykatës doli klient drejtpërdrejtë, blerës i drejtpërdrejtë nga personi paditës i shtetit, kompani paditëse e shtetit", tha Rama.

FJALIMI

Berisha: Në skandale seksuale të përfshirë edhe ministra

Ish-kryeministri i vendit Sali Berisha e ka quajtur "burrec" kryeministrin Edi Rama, ndërkohë që ka shtuar se ai flet në Kuvend dhe largohet prej tij duke i'a mbathur. Sipas Berishës Rama është kthyer në Koproal, që sipas tij do të thotë fjalë e menderosur, që mundohet të mbulojë skandalet e qeverisjes së tij. "E vërteta është që unë flas për qytetarët dhe deputetët. Nuk flas për burrecë si Edi Rama që flasin e ia mbathin. Vjen këtu me koprolali (fjalë të menderosura) që përpiqet të mbulojë skandalet e tij. Rama është përgjegjës për ngritjen e llumit në piedestal. Skandali Xhelili është vetëm një nga dhjetëra skandalet në të katër anët e vendit". Nga ana tjetër, Berisha ka akuzuar Ramën si personi që la të arratisë ish drejtorin e Shërbimit të Transportit Rrugor në Sarandë, Balili. "Pse e le të ikte Balilin. Ti e ke lejuar" tha ai. Sa i takon çështjes së përgjimeve, Berisha i ka bërë thirrje autoriteteve të Italisë, konkretisht Prokurorisë që të hetojë dhe të bëjë transparencë për çështjen e pajisjes që ka përgjuar edhe Presidentin. Këtë veprim, Berisha e ka konsideruar banditesk. Nga foltorja e kuvendit, Berisha tha se shumë shpejt do të dalin në dritë video të ministrave të kabinetit qeveritar. "Peshë herë më zi se Xhelili janë këta që janë pas shpinës time. Prisi se do të dalni të tjerat. Sepse ju vendosët si këmbës të Koços, të si vëllaut të kryeministrit të jugut, Agronin pedofil, i cili jo që kërkonte seks për vend pune, por me minorene", u shpreh Berisha.





Ministri i Brendshëm, Saimir Tahiri u shpreh nga foltorja e Kuvendit se policia italiane i ka dhënë përgjigje akuzave për përgjimit. Sipas tij, përgjigja e Ministrisë së Brendshme italiane ka përfshirë të gjitha akuzat e hedhura përgjatë një jave. Tahiri konfirmoi dhe njëherë tjetër se pajisja nuk është përgjuese, por vetëm didaktike e cila nuk ka kapacitete teknike për të gjurmuar telefonatat. “Sot kjo çështje ka marrë një përfundim. Është drejtori i Policisë italiane, i cili informoi Prokurorin se nuk është një pajisje përgjimi, nuk ka pasur kurrë një pajisje përgjimi, se nuk ka ndodhur kurrë që policia italiane të ketë sjellë në Shqipëri një pajisje përgjimi! Edhe ajo pajisje që ka ardhur nuk ofron mundësi teknike që të bëjë përgjime të ligjshme. Se edhe ajo pajisje trajnimi është një pajisje didaktike, e cila edhe sikur të çmendet një operator, nuk mund të bëjë përgjime sepse nuk ofron kapacitet teknik. Pra, policia italiane deri tani dhe nënkuptuar sipas jush, e përfshirë në këtë megaskandalin. Në qoftë se ishte pajisje përgjimi, mirë unë bandit, por edhe ata bandit, mirë policia e shtetit e mbushur me bandit, por edhe ata të mbushur me bandit, se qenkan shkullor italianët dhe vikan për të përgjuar Salinun, edhe Lulin. Ky skandal mori një përfundim zyrtar, me një shkresë zyrtare nga Ministria e Brendshme dhe Ministria e Jashtme italiane”, u shpreh Tahiri. Ai i bëri thirrje Presi-

Përgjimi, Tahiri: Nishani të dalë dhe të kërkojë ndjesë, shpifi

Ministri: “Nishani doli në konferencë për shtyp për halle politike të PD-së”



për të gjithë ju: kush do t'i dalë në mbrojtje Presidentit të Republikës, se është në ditën e vet të hallit. Kush do ta shpëtojë Presidentin nga ky hall i madh që shkuli të madh dhe të vogël në Shqipëri se Policia e Shtetit përgjion. Kur mësova se sot Presidenti do t'i kërkonte ndjesë qytetarëve dhe t'u thotë: më falni, mora një informacion gojor. Presidenti doli për halle politike të SHQUP-it. Si mund të rrijë ende në detyrë Presidenti i Republikës? Çfarë lloj Presidenti është ky që del në Tv dhe del e i thotë publikut se është cenuar siguria kombëtare dhe këtë e ka me thashetheme. Tani që përgjeshtronet zyrtarisht, tani që autoritetet italiane e përgjeshtronjnë, çfarë do të bëjë Presidenti? Kush e shpëton Nishanin? Si mund të rrijë në detyrë kur doli dhe nxori alarmin se policia përgjion? Çfarë do bëjë Presidenti?”, theksoi Tahiri.

dentit të Republikës që të dalë dhe të kërkojë ndjesë për alarmin fals që lëshoi se është përgjuar. Sipas tij, Nishani doli në konferencë për shtyp për halle politike të PD-së. “U ngrit një furtunë në gotë që lebetiti gjithë Shqipërinë. Sot kjo çështje ka marrë minimumin një përfundim tjetër. Pra, pasi nuk u kursye as Presidenti të dilte publikisht dy herë, të vinte alarmin publik dhe t'i adresojë shqiptarëve, një popull të tërë duke i thënë që ka një pajisje përgjimi të konfirmuar siç tha Presidenti dhe kjo cenon sigurinë kombëtare. Unë kam një pyetje

Kërkesa

Noka: Të shkarkohen Tahiri e Çako, pengojnë hetimin e përgjimeve

Deputeti i PD, Flamur Noka, kërkoi arrestimin e Ministrisë së Brendshme dhe drejtorit të Policisë së Shtetit, Haki Çako, për çështjen e përgjimeve. Sipas tij, dy zyrtarët e lartë po pengojnë hetimet për zbardhjen e të vërtetës rreth përgjimeve. “Drejtori i Përgjithshëm i

Policisë ishte memec dje në komisionin. Duhet të japë dorëheqje e të arrestohet. Të arrestohet edhe ministri i Brendshëm. Duhet të arrestohen sepse po pengojnë hetimet për skandalin e përgjimeve”, u shpreh Noka. Ndryshe nga sa pretendoi ministri i Brendshëm Saimir Tahiri se nuk ekziston një pajisje përgjimi, për demokratët përgjimi ka ndodhur dhe se ka prova të cilat do të dalin. “I kemi të dhënat! I kemi informacionet! Është përgjuar! Janë përgjuar



politikanë, ambasadorë. Erjon, je përgjuar edhe ti! (i drejtohet Erjon Braçes pas reagimit të tij nga salla)”, tha Noka. Nën kryetari i Komisionit të Sigurisë dhe detaje sesi ka hyrë pajisja në vendin tonë, madje edhe për mjetin me të cilin është transportuar. “Pajisja ka hyrë dhe ka hyrë me një mjet BMW X5 ngjyrë e zezë dhe ka qarkulluar edhe nëpër kryeqytet”, deklaroi ai.

Radikalizohet Presidenti, fyerje të rënda ndaj kryeministrit

Nishani: Sjellja e Ramës në Kuvend, ordinere dhe e paprecedent

Presidenti Bujar Nishani i është drejtuar dje me një gjuhë të paprecedentë kryeministrit të vendit duke e quajtur me sjellje ordinere. Nëpërmjet një reagimi zyrtar në faqen e Presidençës, Nishani është shprehur se është i indignuar nga sjellja e Kryeministrit dhe se sjellje kaq ordinere nuk ka parë ndonjëherë në Kuvend.

Sipas tij të fyesh Kryetarin e Shtetit duke shfrytëzuar një vend ku Presidenti nuk është prezent është paburrëri e pashembull. “Kryeministrit aktual ta lerë më së fundi ‘shoun’ dhe ekzibicionin dhe të fillojë menjëherë nga puna për të cilën është ngarkuar që tre vjet më parë”, ka vijuar Nishani. “Institucioni i Presidentit të Republikës është i indignuar nga sjellja e paprecedent e Kryeministrit aktual në Parlament, i cili duke keqpërdorur aulën e Kuvendit të Shqipërisë fyen dhe shpif ndaj Presidentit të Republikës. Sjellje kaq ordinere nuk ka ndodhur kurrë më parë në sallën e Parlamentit shqiptar. Të fyesh Kryetarin e Shtetit duke shfrytëzuar një vend ku Presidenti nuk është prezent është paburrëri e pashembull.” -thuhet në deklaratën e Presidentit. Nishani i kërkon Ramës luftimin e kriminalitetit dhe ofrimin e shërbimit shëndetësor për



qytetarët. “Gjithashtu i kërkon Kryeministrit aktual të largojë urgjentisht nga administrata e shtetit individët e përfshirë në veprimtari kriminale. Të krijojë mundësitë për punësim të qytetarëve të vendit, të cilët po vuajnë nga një situatë e rëndë ekonomike. Të luftojë bandat e krimit të organizuar. T'u ofrojë shërbimin shëndetësor publik qytetarëve që

vuajnë çdo ditë nga nevojja për trajtim mjekësor. Të luftojë korrupsionin e përmasave shqetësuese në dëm të pasurisë publike dhe private të qytetarëve shqiptarë. Të mos blloktojë reformën e sistemit të drejtësisë, por të ofrojë kompromisin e nevojshëm për miratimin e saj”, -thuhet në deklaratën e Presidentit të Republikës.

STUDIO PËRMBARIMORE “SPEED SOLUTION” NJOFTON SHPALLJEN E ANKANDIT 1 PËR:

APARTAMENT me sipërfaqe 106.67 m², Zona Kadastrele: 3866, Numri i Pasurisë: 315/604+1-20, Vol.104, Fq.19 me vendodhje Yzberisht, Tiranë, që vlerësohet në shumën **5,976.000 (pesë milionë e nëntëqind e shtatëdhjetë e gjashtë mijë) Lekë.**

Ankandi do të zhvillohet më datë **31.05.2016, Ora 16:00**, pranë Studios Përmbarimore “SPEED SOLUTION” me Adresë: Bulevardi “Gjergj FISHTA” Kulla. 1, Kati, 2. Nr.3, Tiranë.

Për çdo informacion mund të kontaktoni
cel.0693041355; 0696334695; e-mail: speed.solution@yahoo.com

Blushi: Roshi më kërcënoi! Ja fyerjet që s'u dëgjuan me Ballën

Edi Rama: Nuk debatoj me kopje! Ben Blushi: Nuk jua mban b*tha, shokë të Elvisit!

ESIONA KONOMI
TIRANE

Deputeti socialist Ben Blushi ka denoncuar dje nga foltorja e parlamentit, se kryebashkiaku i Kavajës e kishte kërcënuar, sepse deputeti e kishte cilësuar të inkriminuar. Ai lexoi në sallë një mesazh nga Roshi, në të cilën tha se kishte edhe shumë fyerje që nuk mund t'i lexonte. "O Blush-thotë, jam Elvis Roshi, s'kam bo asnjë krim siç thatë ju dhe shumë shpejt do të dal për sqarim, por borxh nuk të kam ty sa të kem qytetin e Kavajës që më mbështet. Unë...", etj. etj ka ca sharje që po ja kursej publikut. Unë e neverisë këtë qenie, por ç'rëndësi ka", -tha Blushi. Ai i kërkoi kryeministrit të dalë e të shprehet për këtë çështje, teksa e akuzoi Ramën drejtpërdrejt si inkurajues të Roshit. "Pyetja për ty është: pse po ja nxin faqen këtij vendi? Ku e ke këtë aftësi për të grumbulluar kaq shumë të paafte? O zotëri, kë përfaqësoni këtu? Gjithë lumen e Shqipërisë? Kush janë këta njerëz? Të gjithë me precedentë penalë. Ku e gjen ky guximin? E di unë ku e gjen, se një qytetar i thjeshtë s'do ta kishte bërë këtë. Mendon se e mbron ti, ndaj më çon mua mesazh me kërcënime. Këto janë qenie të neveritshme. Çështja është jo pse janë, po pse nuk i kap ligji? Sepse i mbron ti. Dil këtu të lutem e thuj si e ka emrin? Ke ndërmend ta mbros akoma mbas kësaj?" -tha Blushi. Pas kësaj ai u ul në vendin e tij, por tensioni i nxitur nga deputetët e opozitës detyroi Metën të ndërprejë seancën. Por demokratët filmuan dhe publikuan një debat të fortë mes Blushit dhe Ballës, i cili u shoqërua me fyerje mes tyre. Balla i kërkoi fillimisht



Ben Blushi

→ BLUSHI

Të paguajnë njerëzit taksa për të hetuar Elvis Roshin se më ka çuar mua mesazh. Ore, jeni mirë apo s'jeni? Këta duhen përçmuar, siç përçmoj ty dhe kryeministrit tënd që s'ka b*thë të mbrohet.

Blushit ta dërgonte çështjen në prokurori nëse ishte kërcënuar, por ky i fundit tha se nuk donte të harxhonte nga taksat e shqiptarëve asnjë lek kushtuar Roshit. Debatu u thellua kur Blushi e quajti PS-në një grumbullim halabakësh. Në këtë moment Balla e sfidoi deputetin rebel të dilte të provonte veten me votë, sepse ishte një deputet i dalë nga lista. Gjuha e Blushit është ashpër, duke përdorur dhe fjalor

→ BALLA

Kujt i thua parti halabakësh ti more? Mbylle more gojën. Kur u bë kjo parti halabakësh? Kur nuk u bërë ti kryeministër? Të ishte bërë kryeministër, do e shihje sa e mirë ishte kjo partia jote.

të pahijshëm: "Dilni e mbrohuni, por nuk jua mban b*tha!". Shërra ka vijuar edhe me zhurmnajën e opozitës, e cila ka shijuar këtë debat. Blushi është ulur në vendin e vetë e ka thirrur disa herë Ramën: "O frikacak, dil e fol." Në debat e sipër, Berisha ka ndërhyrë disa herë duke e nxitur Ramën të flasë, por ky i fundit është përgjigjur vetëm me një fjali: "Unë debatin e bëj vetëm me origjinalin, jo me kopjet."

DEBATET PA MIKROFON NE KUVEND

Ben Blushi: Meqë ka ardhur sot kryetari i rilindjes, dhe nuk është shumë kollaj ta gjeshe këtu, kam sot një pyetje direkte për të, ndaj e kërkova fjalën për procedurë. Para një jave në këtë sallë jam ngritur e kam thënë në këtë sallë se si ka mundësi që kryetari i Bashkisë së Kavajës, deklaron se nuk mban mend se si është dënuar në Gjermani. Mbasi fola këtu më ka ardhur një mesazh dhe unë dua ta lexoj. "O Blush-thotë, jam Elvis Roshi, s'kam bo asnjë krim siç thatë ju dhe shumë shpejt do të dal për sqarim, por borxh nuk të kam ty sa të kem qytetin e Kavajës që më mbështet. Unë...", etj. etj ka ca sharje që po ja kursej publikut. Unë e neverisë këtë qenie, por ç'rëndësi ka. Tani kam një pyetje për ty Ramën, ky e ka emrin Ervin apo Elvis? Kush është ky që më çon mua mesazh? Se ti thua që e ka emrin Ervin. Ai thotë Elvis. Ky e ka numrin 069 600 7770. Kush është ky? Elvisi apo Ervini? Shkon në fushatë e thua: sa mirë që e ka ndryshuar emrin ky Elvisi, pasi një problem si gjithë emigrantët, dhe e ndërroi. Po në KQZ, si shkon ky, si Elvis, apo Ervin? Pyetja për ty është: pse po ja nxin faqen këtij vendi? Ku e ke këtë aftësi për të grumbulluar kaq shumë të paafte? Ervini dhe Elvisin në Kavajë, Shkruin në Peshkopi, Qazon në Elbasan, që para dy muajsh më tha do të vras se kisha bërë një libër. O zotëri, kë përfaqësoni këtu? Gjithë lumen e Shqipërisë? Kush janë këta njerëz? Të gjithë me precedentë penalë. Ku e gjen ky guximin? E di unë ku e gjen, se një qytetar i thjeshtë s'do ta kishte bërë këtë. Mendon se e mbron ti, ndaj më çon mua mesazh me kërcënime. Elvis Roshi...pfff. nëpër lagjet e Tiranës kur kam qenë i vogël kam parë me dhjetëra si puna e atij. Këto janë qenie të neveritshme. Çështja është jo pse janë, po pse nuk i kap ligji? Sepse i mbron ti. Dil këtu të lutem e thuj si e ka emrin? Ke ndërmend ta mbros akoma mbas kësaj?

Balla: Blush dërgoje në prokurori atë që the në Parlament, mos fol këtu.

Ben Blushi: Jo..

Taulant Balla: Pse, nuk shkohet në Prokurori, ë?

Ben Blushi: Nuk shkoj për halabakë unë. Ashtu i keni grumbulluar ju, ti, ky e ai tjetri aty.

Taulant Balla: Ik ore...

Ben Blushi: Ju doni të tallni, jeni fundërrina e këtij vendi. Kë të marr seriozisht unë, ty apo Elvis Roshin? Kallëzim penal thotë. Në prokurori shkohet kur merresh seriozisht. Ky është një palaço. Të shkoj në prokurori për këtë? Të paguajnë njerëzit taksa për të hetuar Elvis Roshin se më ka çuar mua mesazh. Ore, jeni mirë apo s'jeni? Këta duhen përçmuar, siç përçmoj ty dhe kryeministrit tënd që s'ka b*thë të mbrohet.

Taulant Balla: Jeni bërë tre: Basha, Berisha, Blushi. Të të vijë turp. Ke ardhur nga lista e partisë. Shko votohu në popull e shiko sa vota merr. Ik ore..

Ben Blushi: Edhe ti dole nga lista e partisë. Pse more, do merrem me halabakë sipas teje?

Taulant Balla: Kujt i thua parti halabakësh ti more? Mbylle more gojën. Kur u bë kjo parti halabakësh? Kur nuk u bërë ti kryeministër? Të ishte bërë kryeministër, do e shihje sa e mirë ishte kjo partia jote.

Ben Blushi: Ramë, hajde fol këtu.

Taulant Balla: Do flasë ai, do flasë. Por partinë mos e shaj.

Fatmir Mediu: Pandi, të kanë dalë ushtarët prej duarsh.

Ben Blushi: Ngrihu, se ke shok Elvis Roshin.

Taulant Balla: Shok e ke pasur dhe ti.

Ben Blushi: Shok nuk e kam pasur unë, as atë as ty.

Sali Berisha-Ramës: Bëhu burrë, dil vetë. Mos fol me cakenjtë.

Balla: O Sali, nuk marrim urdhra nga ty. Edhe ti edhe Blushi jeni një lloj.

Ben Blushi: Përgjigju aty, përgjigju. Çohu, o frikacak, çohu. Mos rri aty. Dil këtu e fol.

Meta: Ju lutem, fjalën e ka z.Mediu.

Blushi: Ngrihu o frikacak. Ngrihu. Mos më shih ashtu. Shoku Elvisit. Fol.

Ilir Meta: Të lutem, të kemi durimin ti dëgjojmë të gjithë me qetësi.

Ben Blushi: O frikacak...

Topalli: O zoti kryetar, ndërhyri. Nuk është gjë për tu anashkaluar jko.

Ilir Meta: Ju lutem, me qetësi. Mos e ndërprisni zotin Mediu!

Ben Blushi: O frikacak...fol.

Arben Ahmetaj: Ai përgjigjet kur do vetë, jo kur i thua ti, po ulu aty.

Jozefina Topalli: Avash, s'mund të bëni sikur s'ka ndodhur gjë këtu.

Arben Ahmetaj: Nuk do ngelemi peng nga një legjen tani.

Jozefina Topalli: Ju lutem thëni rregulloren e parlamentit.

Edi Rama: Unë debatin e bëj vetëm me origjinalin, jo me kopjet.

KRYEBASHKIAKU I KAVAJËS: ISHA MËSUAR ME BERISHËN, MË RËNDUAN FJALËT E BLUSHIT

Elvis Roshi: Ndjesë për mesazhin e pahijshëm, por mu nxi jeta

Kryetari i bashkisë së Kavajës, Elvis Roshi ka reaguar menjëherë pas deklarimit në Kuvend të deputetit socialist, Ben Blushi, duke pranuar mesazhet, por ka thënë se kjo ka ardhur pas gjuhës denigruese të deputetit. Në një postim në rrjetin social Facebook, Roshi thotë se gjuha e përdorur nuk ishte e duhura që mund të përdoren, por se situata ka arritur kulmin, pasi që nga ardhja e tij në krye të bashkisë së Kavajës, ai dhe familja e tij kanë qenë në qendër të aku-



Elvis Roshi

zave të pavërteta. "Dëshiroj të kërkoj ndjesë për një mesazh të nisur që sigurisht nuk është i hijshëm dhe përmban një gjuhë që nuk duhet përdorur gjithsesi. Kjo ndjesë e imja nuk i drejtohet deputetit Ben Blushi, por të gjithë qytetarëve të Kavajës, që besojnë tek unë dhe më votojnë për të drejtuar bashkinë tonë. E vërteta është se kjo shkelje e imja e etikës ka ardhur pasi më ka ardhur shpirti në majë të hundës. Që nga dita që kam sfiduar në kam fituar ndaj Sali Berishës në

Kavajë, në qytetin që konsiderohet zona më e sigurt e PD, unë dhe familja ime jemi përballur me një lumë shpifjesh, balte dhe denigrimi. Më kanë bërë hajdut, vrasës, e çdo gjë tjetër që i ka nxënë goja Sali Berishës. Epitete që as unë e as familja ime nuk ia kemi borxh kurrkujt për t'i dëgjuar çdo ditë, vit pas viti"-tha kryebashkiaku i Kavajës. Roshi në postimin e tij në facebook, thekson se, akuzat dhe përballjen që ka dëgjuar nga Partia Demokratike nuk e

kishte menduar kurrë që mund ti vinte nga Ben Blushi. "Por ndërsa u mësuam me përballjen e Partisë Demokratike dhe Sali Berishës, nuk ma kishte marrë mendja kurrë se të njëjtin fjalor, të njëjtat sharje e akuzat, do i dëgjoja sot nga Ben Blushi, që foli me gjuhën e Sali Berishës. Kjo është arsyeja pse sot e shkela etikën në komunikim, pasi ndonëse e pafalshme, edhe unë jam një njeri si gjithë të tjerët"-tha Roshi. Sa i takon mesazhit, ai ka thënë se ndoshta

ishite gabim, por se edhe ai është njeri si gjithë të tjerët. Sakaq ka shtuar se ai nuk ka lidhje me krimin. "Por dëshiroj të siguroj çdokënd se unë nuk kam asnjë lidhje me krimin dhe pres me padurim çdo ditë që ligji i dekriminalizimit të zbatohet tek unë i pari për të zbardhur njehëre e mirë të vërtetën, në mënyrë që çdo shqiptar ta kuptojë se unë nuk jam subjekt i atij ligji e ndryshe nga shumë të tjerët, nuk kam asgjë për të fshehur", -përfundon reagimi i Roshit.

Topi: Dënojmë sjelljet e kreut të SHISH, shpërfill institucionet

"Komunikimi i SHISH me institucionet lë për të dëshiruar"

Për çështjen e përgjimeve ka reaguar edhe Fryma e Re Demokratike e ish presidentit të Republikës, Bamir Topi, duke akuzuar drejtorin e SHISH, Visho Ajazi Lika se ka shkelur ligjin. Përmes një njoftimi për mediat, FRD theksoi se drejtori i SHISH ka shmangur institucionet eprore, ndërsa i quan të papërgjegjshme deklaratat e tij në komisionin e Sigurisë Kombëtare dhe sjelljet në mënyrën e komunikimit zyrtar me institucionet. "Gjatë raportimit të kreut të SHISH në komisionin parlamentar të Sigurisë Kombëtare u bë më dëshmitar konkret sesi titullarët shkelin ligjin. Visho Ajazi Lika e pranoi publikisht se informacionin për pajisjen e përgjimit e ka ndarë me



Bamir Topi

Vartësia
Kryeministria është institucioni epror për SHISH. Dhe jo pa qëllim sipas ligjit në fuqi, kryetari i SHISH-it emërohet dhe shkarkohet me propozim të Kryeministrit dhe me vendim të Presidentit.

Presidentin e Republikës, por jo më Kryeministrin dhe as me Policinë e Shtetit, pa varësisht se ligji e detyron atë që të mos shmangë Kryetarin

e Këshillit të Ministrave për çështje që cenojnë Sigurinë Kombëtare. Aq më tepër kur institucioni i Kryeministrit është institucioni epror për SHISH. Dhe jo pa qëllim sipas ligjit në fuqi, kryetari i SHISH-it emërohet dhe shkarkohet me propozim të Kryeministrit dhe me vendim të Presidentit. Çka do të thotë se dy institucionet janë në raporte ndërveprimi dhe asnjëra palë s'mund të shmanget nga detyrimi ligjor për t'i informuar,

thuhet në deklaratën e FRD. Fryma e Re Demokratike thekson gjithashtu se sjellja dhe mënyra e komunikimit të kreut të SHISH, është larg nga sjellja e një titullari të një institucioni kushtetues. "Komunikimi zyrtar i SHISH me institucionet lë për të dëshiruar dhe njëherazi është treguesi konkret se jemi përpara një shkeljeje ligjore flagrante", thekson FRD duke shtuar se çështja e përgjimeve u stis për të shtyrë reformën në drejtësi.

Takimi TIRANE

Idrizi: Sfidë jonë, të forcojmë rolin e gruas dhe të rinjve

Kreu i PDIU, Shpëtim Idrizi foli dje në një takim për elektoratin. Në fjalën tij ai foli për arritjet politike deri tani dhe objektivat që ka për të ardhmen. Idrizi theksoi se zgjidhja e çështjes çame është shumë afër. Ai tha se më 21 maj do të zhvillohen zgjedhjet brenda partisë për të gjitha strukturat e saj.

"Do të ketë riorganizim të partisë, duke shtuar se do të forcohet roli i gruas dhe pjesëmarrje 30 përqind e të rinjve në parti", u shpreh Idrizi. Shpëtim Idrizi tha se PDIU nuk është vetëm parti e çame, por është parti e çdo shqiptari. Në 21 maj do të zhvillojmë zgjedhje sipas parimit një anëtar një votë për të gjitha strukturat. Të

"Do të ketë riorganizim të partisë, duke shtuar se do të forcohet roli i gruas dhe pjesëmarrje 30 përqind e të rinjve në parti"

gjithë anëtarët e PDIU-së do tu drejtohen kutive të votimit në datën 21 maj, për të zgjedhur strukturat

në çdo qytet e fshat, si dhe për të zgjedhur kryetarin e partisë me parimin një anëtar, një votë. Në zgjed-

hjet e 21 majit do të jenë dy kandidatët për kryetarë të PDIU-së. Shpëtim Idrizi, kryetari aktual i PDIU-së dhe Halil Hysemi që mban postin e zëvendësministrit të jashtëm. Përpara se të shkojnë në votim, ditën e shtunë, ata do të prezantojnë publikisht platformat e tyre, në një dëgjese publike.



Shpëtim Idrizi

SOS FSHATRA T E FËMIJËVE SHQIPËRI

Shoqata SOS Fshatrat e Fëmijëve Shqipëri është një organizatë private, pa qëllime fitimi, humanitare, jo-politike dhe jo fetare, që ofron kujdes afatgjatë me bazë familjare për fëmijët dhe të rinjtë, të cilët kanë humbur prindërit apo që për arsye të ndryshme nuk mund të jetojnë me prindërit e tyre. SOS Fshatrat e Fëmijëve mbështet gjithashtu fëmijët dhe familjet në nevojë përmes projekteve, që synojnë zhvillimin e kapaciteteve të tyre.

Shoqata SOS Fshatrat e Fëmijëve, Shqipëri shpall konkurrimin për vendin e lirë në pozicionin:

DREJTUES I DEPARTAMENTIT TE ZHVILLIMIT TE FEMIJES DHE FAMILJES NE PROGRAMIN E SOS FSHATIT TE FEMIJVE, TIRANE

Kriteret e kërkua:

- Te kete perfunduar studimet e larta per Pune Sociale/Psikologji (preferohet Master ne fushat perkatese)
- Te kete eksperience pune ne punen me femijet, te rinjte dhe familjet te pakten 3 vjet
- Te kete njohuri mbi ligjin aktual te mbrojtjes se femijeve dhe te drejtat e femijeve dhe sistemit social ne Shqiperi
- Gadishmeri per angazhim afatgjate
- Te zoteroje gjuhen angleze

Personi duhet te kete:

- Aftesi shume te mira drejtuese, organizuese
- Aftesi ne planifikim, zhvillim, monitorim, raportim dhe vleresim;
- Aftesi ne vendimarrje dhe ne menaxhim ne situatat konfliktuale;
- Aftesi per te menduar strategjikisht dhe per te planifikuar veprimet ne perputhje me rrethanat
- Aftesi shume te mira komunikuese me shkrim dhe me goje
- Aftesi per te ndertuar ekip pune dhe te kordinoje punen ne grup
- Aftesi te punoje nen stres; aftesi te mbaje nje balance te mire midis punes dhe jetes
- Flexibilitet
- Pergjegjshmeri dhe korrektesi

Përgjegjësitë kryesore te Drejtuesit te Departamentit te Zhvillimit te Femijes dhe Familjes:

- Realizon kordinimin, monitorimin dhe vleresimin e cilësisë së mbështetjes psikologjike dhe pedagogjike dhe pedagogjike te femijeve ne Program ne perputhje me standartet e kerkuara dhe nevojat e perfituesve;
- Drejton monitorimin e analizave te nevojave per mbështetje psikologjike dhe edukative per fëmijët dhe familjet;
- Planifikon aktivitetet te rregullta te vetë-vlerësimit në fushën e mbështetjes psiko/sociale/pedagogjike dhe ndihmën ndaj femijeve dhe femijëve;
- Siguron qe cdo femije/ familje ka Planin e vet te Zhvillimit, i cili vleresohet rregullisht.
- Rregullisht kryen analiza te praktikave me te mira, dhe sukseseve ne fushen e ndihmës psikologjike dhe pedagogjike ne mbështetjen e familjes dhe femijëve;
- Siguron mbështetje profesionale zhvillimore ekipit qe drejton.
- Kordinon aktivitetet e caktuara te departamentit me njësitë tjera në mënyrë që të sigurohet që shërbimet ofrohen në të gjitha njësitë
- Siguron implementimin e të gjitha parimeve dhe procedurave që dalin nga Politika e Mbrojtjes së Fëmijëve

Personat e interesuar janë të ftuar të paraqesin brenda datës **25.05.2016** në adresën enkelejda.tefa@soskd.org al dokumentat e mëposhtme:

1. Curriculum Vitae; 2. Letër interesi; 3. Reference pune;

Vetëm aplikantët e përzgjedhur do të kontaktohen për intervistë.

SOS FSHATRA T E FËMIJËVE SHQIPËRI

Shoqata SOS Fshatrat e Fëmijëve Shqipëri është një organizatë private, pa qëllime fitimi, humanitare, jo-politike dhe jo fetare, që ofron kujdes afatgjatë me bazë familjare për fëmijët dhe të rinjtë, të cilët kanë humbur prindërit apo që për arsye të ndryshme nuk mund të jetojnë me prindërit e tyre. SOS Fshatrat e Fëmijëve mbështet gjithashtu fëmijët dhe familjet në nevojë përmes projekteve, që synojnë zhvillimin e kapaciteteve të tyre.

Shoqata SOS Fshatrat e Fëmijëve, Shqipëri shpall konkurrimin për vendin e lirë në pozicionin:

LIDER I KUJDESIT ME BAZE FAMILJEN (FBC) NE PROGRAMIN E SOS FSHATIT TE FEMIJVE, TIRANE

Kriteret e kërkua:

- Te kete perfunduar studimet e larta per Pune Sociale/Psikologji (preferohet Master ne fushat perkatese)
- Te kete te pakten 5 vjet eksperience pune ne fushen e kujdesit alternativ te femijeve / te rinjte
- Interes per te punuar me femijet dhe te rinjte ne kujdesin alternativ
- Te kete njohuri shume te mira mbi ligjin aktual te mbrojtjes se femijeve dhe te drejtat e femijeve dhe sistemit social ne Shqiperi
- Gadishmeri per angazhim afatgjate
- Te zoteroje gjuhen Angleze

Personi duhet te kete:

- Aftesi shume te mira menaxheriale
- Aftesi te marre vendime dhe te menaxhoje situatat konfliktuale
- Aftesi per te mbështetur stafin ne zhvillimin e tij
- Aftesi per te ndertuar grup pune efektiv
- Aftesi shume te mira komunikuese me shkrim dhe me goje
- Aftesi te punoje nen stres; aftesi te mbaje nje balance te mire midis punes dhe jetes
- Aftesi organizative
- Flexibilitet
- Pergjegjshmeri dhe korrektesi

Përgjegjësitë kryesore te Liderit te FBC:

- Siguron cilësimin e kujdesit ndaj femijeve dhe te rinjte sipas modelit te SOS;
- Siguron zhvillimin e punonjeseve nen varesi dhe drejton dhe mbështet cdo SOS Nene per sigurimin e mirëqenies se familjes se saj;
- Drejton dhe mbështet liderat e komuniteteve rimore dhe nxit lidhjet e forta midis familjeve SOS dhe liderave rimore si dhe punonjeseve te kujdesit me baze familje.
- Siguron qe te drejtat e femijeve dhe te rinjte njihen dhe respektohen. Te drejtat dhe shqetesimet e tyre jane thelbi i punes se tij.
- Eshte pergjegjes per implementimin e politikave, manualeve standarteve dhe udhezimeve te organizates, implementimin e sistemeve administrative duke nxitur perdorimin efcient dhe ne menyre te pergjegjshme te burimeve financiare dhe aseteve te fshatit.
- Merr pjese aktive ne procesin e planifikimit strategjik, vleresimin dhe kontribon ne menyre aktive ne zhvillimin e metejshem te programit SOS
- Nderton partneritet me komunitetin dhe autoritetet vendore.


Personat e interesuar janë të ftuar të paraqesin brenda datës **25.05.2016** në adresën enkelejda.tefa@soskd.org al dokumentat e mëposhtme:

1. Curriculum Vitae; 2. Letër interesi; 3. Reference pune;

Vetëm aplikantët e përzgjedhur do të kontaktohen për intervistë.

NË FOTO:

Faksimile e kontratës së gjyqtarit Arjan Qafa me kompanin Gener2



AKUZAT NE VITIN 2014 NGA ILDKP

1) Qafa është kallëzuar në Prokurori nga Inspektori i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive, për fshehje pasurie dhe deklarim të rremë të pasurisë. Gjyqtari i dekretuar nga Presidenti Nishani është kallëzuar asokohe, në cilësinë e ish-Inspektori në Këshillin e Lartë të Drejtësisë, pra të njeriut, të ngarkuar me ligj, për kontrollin e punës dhe integritetit të gjyqtarëve. Për rastin në fjalë, ILDKP ka njoftuar zyrtarisht KLD dhe Pastrimin e Parave.

2) Fshehje të Depozitës në shumën 100.000 lekë të reja.

3) Fshehje të Llogarisë rrjedhëse në shumën 2400 €

4) Deklarim të rremë si dhuratë në shumë 37.000 Euro, të cilat i ka disponuar kesh dhe më pas i ka përdorur për blerje Apartamenti.

5) Deklarim i rremë dhe mungesë e burimit ligjor të shumës 70.000 Euro kesh nga bashkëshortja në vitin 2008.

6) Deklarim i rremë dhe mungesë e burimit ligjor, para të dhëna hua nga bashkëshortja e z. Qafa prej 50.000.000 lekë, të cilat i paska dhënë me fajde, dhe ka përfutur prej tyre, 9 milion në 2009, 9 milion në 2010 dhe 12 milion në 2011.

Bashkia e Tiranës vijon betejen e saj kundër trupit Gjyqësor të cilin e quan të montuar pasi gjyqtarët kanë lidhje të drejtëpërdrejta me ndërtuesit e firmës Gener 2 që po merret me ndërtimin e 17 katëshit tek diga e liqenit. "Shqiptarja.com" siguron kontratën e gjyqtarit Arjan Qafa që e implikon atë direkt me firmën që po kryen punimet tek pallati 17 katësh tek diga e liqenit. Qafa ka lidhur kontratë nga 11 Marsi 2010 me 'Gener 2' për shtëpinë ku ai jeton aktualisht që ndodhet në rrugën "Jordan Misja" në kryeqytet midis stacionit të Trenit dhe zonës së 'Don Boskos'. Në deklaratën e pasurisë së Qafës pranë ILDKPI-së vlera e shtëpisë që ai i ka blerë Gener 2 është vetëm 40 mijë euro për 107.16 metra katror në vitin 2010. Ndërkohë që vlera e tregut për një banesë të tillë është afërsisht 1300 euro metri katror, por pavarësisht kësaj Qafa duket se e ka marrë shtëpinë vetëm me koston e ndërtimit: 1 metër katror për 267 euro, pra 5 herë më pak se vlera e tregut.

ARBION MAZNIKU

Ndërkohë më herët në një deklaratë për mediat nënkryetari i Bashkisë Arbion Mazniku ashtu sikurse kishte paralajmëruar mëngjesin e kësaj të enjteje kryebashkiaku ka bërë publike faktet që implikojnë drejtëpërdrejt gjyqtarin Arjan Qafa me firmën Gener 2. "Por, sot po publikojmë fakte të tjera, edhe më tronditëse, të cilat ulërasin se ky gjyq është i montuar dhe kjo trupë gjyqtarësh është e diskutuar, prandaj edhe s'mund ta gjykojë çështjen e pallateve që do të shkatërronjë Liqenin e Tiranës. Së pari, data e gjyqit është vendosur krejt jashtë afatave normale kohore për këtë shkallë gjyqësori. Së dyti, dy gjyqe i janë dhënë të njëjtës trupë mbi të cilën rëndojnë dyshime të arsyeshme - të cilat tashmë janë fakte të qarta - që është palë me ndërtuesin. Së treti, kërkesa jonë e parë për të ndryshuar trupin gjyqësor, së pari u gjykua në fshehtësi, e në shkëlqje të plotë të procedurave normale. Së katërti, kërkesa jonë e dytë në dritën e fakteve të reja për lidhjet me trupit gjyqësor dhe kompanisë ndërtuese u rrezua nga gjykata. E së pesti, sërisht sot kemi fakte të reja që ky është një gjyq i monutar, i ndërtuar me kujdes në detaje prej kohësh për të dëmtuar interesat e

Gjyqtari Qafa i bleu 'Gener 2' shtëpi 107 m2 për 40 mijë euro

Zbulohet kontrata, shtëpia u ble nga gjyqtari me vlerë 5 herë më pak se ajo e tregut

Apeli Përrjashtimi i gjyqtarit, shtyhet vendimi për 25 maj

Apeli administrativ ka vendosur të shtyjë vendimin për shtyrtimin në themel të vendimit për pallatin 17 katësh tek diga e liqenit Artificial për në datën 24 maj. Ndërkohë që është shtyrë edhe vendimi për shtyrtimin e kërkesës së bashkisë së Tiranës për përjashtimin ose jo të gjyqtarit Arjan Qafa i cili rezultoi të ketë një kontratë banese me firmën 'Gener 2'. Kërkesën e Bashkisë Apeli do ta shtyrtojë në datën 25 maj



Arjan Qafa

qytetit, në favor të interesave të pak njerëzve, të ndërtuesit, Saliut, Nishanit, Lulit e me rradhë. Gjykatësi Arjan Qafa është në konflikt të pastër interes, pasi më datë 11 Mars 2010 ka lidhur një kontratë porosi për shtëpi dhe garazh me kompaninë

"Gener 2". -tha Mazniku.

FSHEHJA E PASURISË

Në fjalën e tij Mazniku tha gjithashtu se Qafa rezultoi të jetë i akuzuar për fshehje pasurie në vitin 2011. "Arjan Qafa është në konflikt të pastër interesi, pasi më datë 11 Mars 2010 ka lidhur një kontratë porosi për shtëpi dhe garazh me kompaninë "Gener 2". Në një situatë normale ky fakt duhet të kishte qenë i mjaftueshëm që zotëria në fjalë të kërkonte vullnetarisht të mos gjykonte këtë çështje. Kjo do të kishte qenë funksionimi normal i sistemit të drejtësisë. Por jo! Qartësisht, ky rast po provon katërcipërisht së sistemi gjyqësor është i kapur nga një bandë dhe i shërben interesave të disave, por jo interesave të qytetarëve, jo interesave të qytetit. Nuk ka asnjë shpjegim tjetër që mund të justifikojë veprimet e gjykatës dhe sistemit përballë fakteve".

KONFLIKTI

Një ditë më parë apeli i gjykatës rrezoi kërkesën e Bashkisë, IKMT, dhe avokurtes së shtetit për ndryshimin e treshes së gjyqtarëve të kësaj çështje, që sipas këtyre insitucioneve ishin në konflikt interesi. Pas gjyqtarës Enkelejdja Metaliaj që është e afërmeja e e aksionierit të Kompanisë "Gener 2" Artan Metaliaj, Bashkia e Tiranës denoncoi faktin se edhe gjyqtari Arjan Qafa me date 11 Mars 2010 ka lidhur një kontratë me "Gener 2". Gjyqtarja tjetër është Alklima Gazidede, e cila dha dorëheqjen me heret nga kjo çështje por që nuk u pranua nga kreu i gjykatës. Bashkia e Tiranës kërkon që të pezullohen punimet për pallatin 17 katësh tek diga me argumentin se leja e dhënë për ndërtimin e tij është abuzive.

OFERTË PUNËSIMI

Kompania mediatiqe Shqiptarja.com kërkon të punësojë menaxher marketingu që plotëson kriteret e mëposhtme:

- Të ketë arsim të lartë
- Të ketë përvojë pune
- Të jetë i gatshëm për të punuar në terren

Personat e interesuar të dërgojnë CV e tyre në adresën: marketing@shqiptarja.com

Presidenti

Bujar Nishani padit Erion Veliajn: Dua 100 lekë dëmshpërblim



Presidenti i Republikës, Bujar Nishani ka paditur në gjykatë kryebashkiakun Erion Veliaj. Padia ka ardhur pas akuzave të kryetarit të Bashkisë në një emision televiziv se Nishani ka grabitur pronën e një kishe në Elbasan. Në regjistrimin e padisë, thuhet se Nishani kërkon dëmshpërblim për dëmin moral të pësuar prej cenimit të nderit dhe personalitetit

në vlerën 100 lekë të reja. Gjithashtu, në kërkesëpadi kërkohet që "pala e paditur të përgënjeshtrojë deklaratat e bëra duke publikuar me shpenzimet e veta në emisionin "Opinion" të TV Klan dhe mediat kombëtare vendimin e Gjykatës". Dy javë më parë, përmes një deklaratë për shtyp, kreu i Shtetit Nishani tha se për akuzat e Veliajt në adresë të tij do të përgjigjet drejtësisë.

Rama për Euronews: Shqipëria s'është burimi i të këqijave në Europë

Kryeministri në një intervistë për "Euronews" ka deklaruar se, Shqipëria do të finalizojë brenda një kohe të shkurtër reformën në drejtësi

Kryeministri, Edi Rama në një intervistë për "Euronews" ka deklaruar se, Shqipëria do të finalizojë brenda një kohe të shkurtër reformën në drejtësi që është dhe çelësi kyç në integrimin e vendit në Bashkimin Evropian. Por, Rama flet për "vështirësi të mëdha". "Reforma nuk do të vonojë shumë. Kemi një vit e disa muaj që punojmë dhe tani po finalizohet. Është një reformë konstitucionale, një reformë fundamentale dhe një reformë që ndryshon plotësisht sistemin e drejtësisë. Dhe sigurisht që është shumë, shumë e vështirë", shprehhet Rama. Kryeministri thekson se kjo reformë jo vetëm që do t'i hapë rrugën Shqipërisë për anëtarësimin në BE, por do t'i japë fund "historisë së Shqipërisë së korruptuar dhe të inkriminuar".

NË FOTO:
Kryeministri
Edi Rama



Fillojmë me Misionin Evropian. Shqipëria ka kandiduar në vitin 2014. Që nga fillimi i vitit ju kemi këmbëngulur që të fillojnë bisedimet. Çfarë është kaq atraktive për Bashkimin Evropian për ju kur shkoni gjenden në të cilën është?

Unë mendoj se ne dhe Ballkani, në përgjithësi, nuk kemi harruar atë çfarë është haruar në Europë, që Bashkimi Evropian është mbi të gjitha, një projekt për paqe dhe prosperitet. Ju duhet të kujtoni vizitën time të parë në Serbi pas 68 vitesh në Beograd, dhe më pas homologu im serb erdhi në Tiranë për herë të parë në historinë e dy vendeve që kanë zhvilluar një luftë kundër njëri-tjetrit. Dhe pse? Sepse ne të gjithë jemi bashkuar në këtë përpjekje për të qenë pjesë e Bashkimit Evropian. Dhe në qoftë se Europa ka problem ne nuk duhet ta trajtojmë si diçka që nuk funksionon, por ka nevojë për leadership dhe guxim për të vazhduar përpara.

Në qoftë se Bashkimi Evropian është në probleme çfarë të mirë do i sillte Shqipëria, e cila ka më shumë probleme?

Kjo është pikërisht arsyeja që Marine Le Pen dhe aleatët e saj në Europë kanë dhënë. Ata kanë përhapur propagandë kundër të ashtuquajturit zgjerim, por Evropa do të bëhet më e fortë në qoftë se ne të përfunduar të këtij projekti

nuk lënë një zonë gri në mes të Evropës.

Gjithsesi, para se të filloni për bisedimet e anëtarësimit, Brukseli thotë se keni nevojë për një rregullim të madh të sistemit tuaj të drejtësisë. Progresi për këtë ka qenë i ngadalshëm, kryesisht për shkak të konfliktit mes qeverisë tuaj dhe opozitës, e cila ka ngadalësuar gjërat. Si do të dilni ju nga kjo situatë e komplikuar?

Reforma nuk do të vonojë. Në e nisem këtë rrugë para një viti dhe është në proces përfundimi. Kjo është një reformë themelore dhe radikale kushtetuese e cila do të ndryshojë tërësisht sistemin tonë gjyqësor. Dhe, po, është shumë shumë e vështirë. Ka diskutime, dhe ndoshta do të ketë akoma më shumë.

Cili është afati kohor? Kur ju mund të miratoni Reformën?

Ne duam të hapim bisedimet e anëtarësimit në fund të vitit. Ne duam të kalojmë reformën në kohën kur Këshilli i Europës të takohet. Dhe kjo do të kalojë. Nga ana tjetër duhet të përfundojë kjo historia që Shqipëria është e korruptuar dhe kriminale.

Nuk ka gjyqtar të korruptuar në Shqipëri?

Duhet t'i japim fund historisë së Shqipërisë dhe Ballkanit të korruptuar dhe të inkriminuar sepse është një stereotip që është krijuar ndër vite për të kriminalizuar lehtësisht këto vende.

Sipas një raportit të antimasias italiane 1/3 e ekonomisë Shqiptare është e kriminale...

Kjo është e neveritshme. Nuk ka pasur asnjë raport që të thotë se 1/3 e ekonomisë shqiptare është e trafikimit të qenieve njerëzore, e drogës, etj.



Kryeministri Edi Rama në Euronews

Cilat janë shifrat tuaja? E mohoni faktin se ka trafikim droge, armësh, trafikim të femrave?

E mohoj kategorikisht dhe ju them se është plotësisht e gabuar që të flisni për trafik

armësh nga Shqipëria.

Pra nuk ka asnjë problem Shqipëria me krimin? Çdo gjë është në rregull?

Pse duhet të shkojmë nga një ekstrem në tjetrin? Nuk

e kuptoj! Nuk ka ndonjë mendim më racional? Apo është nga ana gazetareske interesante për histori të tilla. Ju e përshkruani Shqipërinë si burim i së keqes në Evropë, por kjo nuk është e vërtetë.

Kjo nuk është ajo që thash...

Është një vend që ndryshon çdo ditë, me probleme, me një të kaluar shumë, shumë të vështirë, më e vështira se e të gjitha vendeve komuniste sepse ka qenë e izoluar për 50 vite, jo vetëm në Evropën Perëndimore, por edhe në atë Lindore.

Në fund një pyetje personale. Para se të hyri në politikë, keni qenë piktor. Duke u kthyer pas, nuk jeni penduar që keni lënë botën e artit?

Unë nuk pendohem kurrë për asgjë. Kisha plane të tjera, por tani jam këtu dhe kam marrë përgjegjësinë për të drejtuar qeverinë e vendit tim dhe ky është një privilegj i madh, nderi më i madh që një njeri mund të ketë. Por në të njëjtën kohë unë nuk e kam ndalë punën si artist. Jam artist ashtu siç jam dhe Kryeministër.

Pikturoj gjatë takimeve, gjatë telefonatave, më ndihmon të fokusohem dhe siç e shihni kur nuk pikturoj gjatë intervistave nuk shkon gjithçka vaj.

BURSA TË FONDACIONIT ONASIS PËR KOLEGJIN GREKO-SHQIPTAR ARSAKEIO E TIRANËS

Kolegji greko-shqiptar Arsaqueo e Tiranës, themeluar prej Fondacionit Filepedheftiki, i cili kremen këtë vit 180-vjetorin e funksionimit të Shkollave Arsaquia (jofitimprurëse), njofton se **Fondacioni i Bamirësisë Aleksandros Onasis** ofron për nxënësit e Kolegjit greko-shqiptar Arsaqueo e Tiranës:

- **Tri (3) bursa për nxënësit/et e shkëlqyer të shkollave publike që gjatë vitit**

shkollor 2016-2017 do të studiojnë në klasën X, duke i përjashtuar nga çdo lloj detyrimi financiar për gjithë kohështrirjen e studimeve të tyre gjatë viteve të gjumnazit. Përzgjedhja do të bëhet pas fazës së parë, pra provimit me shkrim në lëndët e Gjuhës shqipe dhe Matematikës, i cili do të realizohet në datën 28 maj, ora 10 paradite si dhe fazës së dytë, pra intervistës së nxënësve që kaluan me sukses provimet, e cila do të realizohet në datën 4 qershor, ora 10 paradite. Për pjesëmarrjen në provime do të jetë i nevojshëm parashtrimi i kërkesës së regjistrimit të të interesuarit, që mund të bëhet në formë elektronike në adresën albania@arsaqueo.gr ose pranë sekretarisë së shkollës (Lundër-Sauk) deri në datën 24 maj 2016. Tel. 048810280.

- **Pesëmbëdhjetë (15) bursa (ulje 50% për vetëm 1 vit) për nxënësit e shkëlqyer**

të Kolegjit greko-shqiptar Arsaqueo e Tiranës (do të merren parasysh dhe rezultatet e tyre në Gjuhën greke) për nxënësit të klasave V dhe IX duke u bazuar në rezultatet e tyre në mësimet.

- **Dymbëdhjetë (12) çmime në formë monetare për nxënësit të Kolegjit**

greko-shqiptar Arsaqueo e Tiranës, duke u bazuar në arritjet e tyre në njohjen e Gjuhës greke.

PD inkriminon KQZ, sulm njeriut të Jozefina Topallit

Opozita akuzon kryetaren e KQZ për bllokimin e ligjit të dekriminalizimit

ADRIATIK DOÇI
TIRANE

Partia Demokratike ka akuzuar dje Komisionin Qendror të Zgjedhjeve se po fsheh krimet e të inkrimnuarave, në funksione të larta publike. Deklarata u artikuloa nga kryetari i grupit parlamentar demokrat, Edi Paloka, ndërsa mesazhi ishte për kryetaren e KQZ, Lefterie Luzi. Kjo e fundit është konsideruar si një investim i Jozefina Topallit në krye të komisionit qendror të administrimit të zgjedhjeve në Shqipëri. Por, devijimi i zonjës Luzi nga urdhrat e Partisë Demokratike, është përjetuar me nervozizëm nga opozita. Akuzat e para në adresë të kryetares së KQZ erdhën gjatë zgjedhjeve të fundit lokale, ku në disa vendimmarrje të rëndësishme, Luzi bashkoi votat me përfaqësuesit e mazhorancës.



Edi Paloka

Partia Demokratike i kërkon sot Komisionit Qendror të Zgjedhjeve të zbatojë ligjin, dhe jo paktin me krimin. Të publikojë të dhënat e të mos fshehtë krimet e të inkrimnuarit. Dekriminalizimi është një arritje e madhe e vendit dhe e qytetarëve, e vlerësuar nga ndërkombëtarët dhe nga Shtetet e Bashkuara si reformë model, dhe nuk mundet dhe nuk ka për t'u

Akuzat

Akuzat e para në adresë të kryetares së KQZ erdhën gjatë zgjedhjeve të fundit lokale, ku në disa vendimmarrje të rëndësishme, Luzi bashkoi votat me përfaqësuesit e mazhorancës.

Paloka

Çdo pengesë, çdo ndalim që i bëhet dekriminalizimit, është një vepër e rëndë penale, dhe ne i sigurojmë ata që e kryejnë këtë vepër penale se do të përgjigjen deri në një para ligji.



ndalur dot nga Edi Rama dhe lefteritë e tij", tha Paloka. Sipas tij, çdo pengesë që i bëhet dekriminalizimit është një vepër e rëndë penale. Ai paralajmëroi se të gjithë penguesit do të përgjigjen para ligjit. "Çdo pengesë, çdo ndalim që i bëhet dekriminalizimit, është një vepër e rëndë penale, dhe ne i sigurojmë ata që e kryejnë këtë vepër penale se do të përgjigjen deri në një para ligjit", deklaroi Paloka.

AFATET

Kryetari i grupit parlamen-

tar demokrat, Edi Paloka, i kujtoi dje Komisionit Qendror të Zgjedhjeve shkeljen e afateve për publikimin e formularëve të dekriminalizimit. "Sot ka skaduar afati ligjor i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për të publikuar në faqen e tij zyrtare, formularët e dekriminalizimit. Nëse futeni tani në faqen zyrtare të KQZ, CEC.ORG.AL, do të zbuloni se ky institucion ka shkelur ligjin e dekriminalizimit, duke mos i publikuar të dhënat, pra formularët e vetëdeklarimit, siç e ka de-



Mbledhja e KQZ

tyrim, sipas vendimit numër 17/2016 të Parlamentit", tha Paloka.

URDHRI

Sipas përfaqësuesit të opozitës, KQZ ka shkelur urdhrin e Kuvendit për publikimin e formularëve të dekriminalizimit. "Kuvendi i Republikës e ka urdhëruar KQZ që ta bëjë këtë publikim, por KQZ nuk e ka bërë. Shkelja e këtij urdhri, është shërbimi që pjesa e kapur e këtij institucioni, i bën Edi Ramës dhe interesave kriminale. Po ashtu, ka skaduar afati ligjor e publikimit të listës së funksionarëve që nuk kanë depozituar formularët e vetëdeklarimit, të cilët janë rreth 40 këshilltarë bashkiakë të mazhorancës", pohoi Paloka.

LIGJI

Afatet për publikimin dhe kontrollin e deklaratave



Sipas ligjit çdo formular vetëdeklarimi regjistrohet në regjistër me një numër unik identifikimi, si dhe ruhet e dokumentohet në rrugë elektronike. Organet përgjegjëse, brenda 15 ditëve nga skadimi i afatit, bëjnë publike listën e funksionarëve publikë që kanë depozituar formularët e vetëdeklarimit pranë tyre. Si rregull, në çdo rast, organi përgjegjës për administrimin merr masa për publikimin e vetëdeklarimeve në faqen zyrtare të tij në internet. Nderkaq, publikimi është i detyrueshëm nëse kërkohet nga një subjekt i interesuar. Po ashtu, brenda 5 ditëve nga skadimi i afatit, organi përgjegjës evidenton funksionarët publikë që nuk kanë depozituar formularët e vetëdeklarimit. Në këtë rast, organi përgjegjës e trajton këtë rast si refuzim për të deklaruar dhe personi trajtohet sikur të ketë rezultuar në një nga rrethanat që përbëjnë kusht për ndalimin e zgjedhjes apo emëritimit të tij në funksionin publik. Nderkaq, brenda 3 muajve nga skadimi i afatit, organi përgjegjës për administrimin e formularit është i detyruar të verifikojë të dhënat e deklaruara.

FORMULARËT/ NË PRITJE TË KOMISIONERIT PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE

Shkresa e KQZ: Ja pse nuk i publikojmë formalët e zyrtarëve

Për Shqiptaren.com, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, ka bërë me dije zyrtarisht arsytet se pse vijon të fshehtë formularët e vetëdeklarimit, të subjekteve të parashikuara në ligj, duke sfiduar ligjin dhe Kuvendin. Disa ditë më parë, Shqiptarja.com i ka kërkuar zyrtarisht KQZ formularët e vetëdeklarimit, bazuar në ligjin për të drejtën e informimit dhe atë të dekriminalizimit. Por në përgjigjen e tij, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, përmes Sekretarit të Përgjithshëm, Skënder Vriuni, u shpreh se këta formularë përbajnë të dhëna sensitive, e për këtë arsye, ky institucion nuk do t'i publikojë ato, deri në marrjen e një vendimi nga Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, që po ashtu, është edhe Komisioneri për të Drejtën e Informimit. "Referuar Ligjit nr. 119/2014

ARGUMENTI

"Referuar Ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", si dhe Ligjit nr. 9887 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", rezultojnë se formularët e vetëdeklarimit përbajnë të dhëna sensitive, ndaj i jemi drejtuar Komisionerit".

"Për të drejtën e informimit", si dhe Ligjit nr. 9887 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", rezultojnë se formularët e vetëdeklarimit përbajnë të dhëna sensitive. Më këto kushte, KQZ i është drejtuar me shkresë numër 2416 prot. datë 10.05.2016, Komisionerit për të Drejtën e Informimit

III. TË DHËNA MBI GJENDJEN GJYQËSORE TË PERSONIT

1. A jeni dënuar ndokohë me vendim gjyqësor të formës së prerë nga një autoritet gjyqësor shqiptar ose i huaj? (Vendos X përtej ndërgjegjës)

PO JO

- Nëse po, specifikoni të dhënat e mëposhtme:

Të dhënat e vendimit gjyqësor		Masa e dënimit me burgim		Vepra penale për të cilën jeni dënuar	
Gjykata	Nr. dhe data e vendimit gjyqësor të formës së prerë	Masa e dënimit me burgim	Neni	Ligji	

dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, duke i kërkuar sqarim se si do të veprojë me këta formularë, pasi përbajnë të dhëna sensitive", thuhet në shkresën e KQZ. Por dy ligjet që citon KQZ, ai i të drejtës së informimit, dhe ai i mbrojtjes së të dhënave personale, janë dy ligje të miratuara me shumicë të thjeshtë, krahasuar me ligjin e dekriminalizimit, i miratuar me shumicë të cilësuar. Ky i fundit, është më i fuqishëm juridikisht ndaj të tjerëve, dhe përcakton se formularët e dekriminalizimit bëhen publikë, pasi ky është dhe qëllimi i vetë ligjit. Në nenin 5, pika 5,6 të këtij ligji,

DY LIGJET

Por dy ligjet që citon KQZ, ai i të drejtës së informimit, dhe ai i mbrojtjes së të dhënave personale, janë dy ligje të miratuara me shumicë të thjeshtë, krahasuar me ligjin e dekriminalizimit, i miratuar me shumicë të cilësuar.

thuhet se të dhënat janë publike, dhe të pakufizuara në asnjë rast. "Këto vetëdeklarime dhe të dhënat e përfshira në të mund të bëhen publike në çdo kohë dhe pa asnjë kufizim para dhe pas datës së zgjedhjeve të përgjithshme apo vendore, votimeve në Kuvend apo emëritimit, me kërkesë të subjekteve të interesuara. Kërkesa për marrjen e formularit të vetëdeklarimit dhe/ose të dhënave të përfshira në të nuk mund të refuzohet apo kufizohet në asnjë rast. Refuzimi apo kufizimi i dhënies së tyre përbën vepër penale, sipas neni 248 të Kodit Penal"-thuhet në ligjin për dekriminalizimin.

OBJEKTI

Kjo sipërfaqe është pasuria më e lakmuar Guxhollit, pasi për këtë pronkanë shfaqur interes për të investuar dhjetëra biznesmenë

NË FOTO:

Pamje e ambienteve të shoqërisë mekanike "Partizani" ku shihen tornot, trapanat dhe presat dhe ambiente tjera



AMBIENTET

ELTON QYNO
TIRANË

Vetëm një muaj pasi do linte detyrën e këshilltares së kryeministrit Sali Berisha, për shkak se në pushtet po vinin socialistët, në fund të muajit korrik 2013 Suzana Guxholli bëhet papritur akcionere e shoqërisë mekanike "Partizani". Guxholli rezultoi të jetë bërë pronare mbi bazën e disa aksioneve të shpikura nga gjykata, pasi asnjë nga pronarët e kësaj shoqërie nuk ka lëvizur nga numri i aksioneve, ndërkohë që Guxholli hyn direkt me kapital të mjaftueshëm në këtë kompani. Emri i Guxhollit është rradhitur mes 115 akcionerëve të kësaj kompanie, e cila tashmë administrohet dhe jep me qera disa ambiente të degraduara të ish-uzinës së përpunimit të enëve të kuzhinës dhe një sipërfaqe toke prej 6293 metra katror. Në fakt kjo sipërfaqe është pasuria më e lakmuar e saj, pasi e ndodhur shumë pranë rrugës së "Don Boskos", (përballë gjykatës Administrative në Tiranë), për pronën në fjalë kanë shfaqur interes për të investuar dhjetëra biznesmenë të njohur të Tiranës. Guxholli ka arritur të "katapultohet" si akcionere në këtë kompani dhe më pas të bllokojë tërësisht aktivitetin e firmës, duke përdorur njohjen familjare me ish-kreun e QKR Tomi Kola dhe një vendim gjykate për ndarjen e pasurisë me ish-bashkëshortin e saj Besnik Pani, ky i fundit një ish-akcioner i shoqërisë mekanike "Partizani", por që në 2004 ia dhuron 3 mijë aksionet shtetasit Sokol Agolli që rezultoi të jetë djali i tezes së tij. Ndërkohë 500 aksionet e tjera të mbetura Pani deklaroi për "Shqiptarja.com" se ia ka shitur nëpërmjet kontratës noteriale shtetasit Kreshnik Agolli. Pani shton se 3 mijë aksionet e dhuruara janë shitur nga Sokol Agolli tek Çesk Oroshi.

NDIHMJA NGA BURRI VAJZËS SË XHAXHAIT

Megjithëse Pani kishte hequr dorë nga të gjitha aksionet e tij dhe ishte larguar nga shoqëria mekanike "Partizani", ish-bashkëshortja e tij kishte ndërmarrë një operacion gjyqësor duke gjurmuar me qëllim tjetërsimin e të gjitha pasurive ku pronar ishte ish-burri i saj. Pavarësisht se këto aksione i janë dhuruar dhe shitur pronave të tretë, Guxholli ka arritur të fitojë gjyqet. Vendimet gjyqësore të fituara nga Guxholli datojnë në dhjetor të 2008 dhe tetor të 2010. Edhe pse që në këtë periudhë vendimet për ndarjen e pasurisë dhe aksioneve të kompanisë, kanë marrë formë të prerë Suzana Guxholli nuk ka pasur

Në ditët e fundit të mandatit, Guxholli pronare e 'Partizanit'

Si u rregjistruan në fund të mandatit aksionet e Guxhollit në QKR nga burri i vajzës së xhaxhait



Suzana Guxholli



mundësi të hyjë si pronare në shoqërinë mekanike "Partizani". Guxholli është bërë akcionere vetëm në korrik të 2013, duke përdorur ndihmën e ish-drejtorit të QKR Tomi Kola, i cili rezultoi të jetë burri i vajzës së xhaxhait të Guxhollit. Kola ka rregjistruar në QKR vendimin e gjykatës së Tiranës që ndante në dy pjesë 3500 aksione, duke i rregjistruar 1788 aksione në emër të mikeshës së tij Suzana Guxholli, duke bërë këtë të fundit autotomatikisht akcionere të shoqërisë mekanike "Partizani". Kola e ka argumentuar këtë rregjistrim aksionesh me faktin se ka respektuar një vendim gjykate. Mirëpo nga dokumentacioni që siguron "Shqiptarja.com" rezultoi se ky respektim i vendimit të gjykatës është bërë në mënyrë të njëanshme, pasi ish-drejtori Tomi Kola ka rregjistruar aksionet dhe ka bërë pronarë të shoqërisë mekanike "Partizani" vetëm Suzana Guxhollin, ndërsa nuk ka rregjistruar asnjë aksion në emër të Besnik Panit siç dhe është shprehur në vendimin e saj gjykate e Tiranës.

Guxholli rezultoi të jetë bërë pronare mbi bazën e disa aksioneve të shpikura nga gjykata, pasi asnjë nga pronarët nuk ka lëvizur nga numri i aksioneve, ndërkohë që Guxholli hyn direkt me kapital të mjaftueshëm në këtë kompani. Hyrja e saj si akcionere është bërë në një kohë kur aksionet e Besnik Panit ishin tjetërsuar nga ky i fundit, disa vite përpara fillimit të operacionit gjyqësor prej ish-bashkëshortes.

GJYQ PËR VEPRIMET E TOMI KOLËS

Ndërkohë që veprimet e ish-drejtorit Tomi Kola janë kryer në ditët e fundit të funksionit të tij, pasi dhe ai është dorëhequr nga funksioni i drejtorit të QKR. Aktualisht veprimet administrative të tij për këtë rast janë bërë objekt i një gjykimi në gjykatën Administrative dhe hetimi në prokurorinë e Tiranës. I kontaktuar në telefon nga "Shqiptarja.com" ish-bashkëshorti i Suzana Guxhollit tregon se në këtë kompani ai nuk ka më pjesë. Kjo pasi sipas tij është tërhequr fillimisht në vitin 2004, ku

i ka dhënë aksionet kushëririt të tij. Pani deklaroi se dhurimi i aksioneve është bërë në kushtet kur ai ska qënë në gjendje të paguante kushëririt një shumë financiare, që ai ia kishte marrë si borxh, për ndërtimin e shtëpisë, prapa burgut 302 në Tiranë. Ndërkohë që pjesën tjetër prej 500 aksione ia ka shitur një personi tjetër, duke u larguar tërësisht nga kjo kompani. I pyetur nga "Shqiptarja.com" se vetë Besnik Pani si kishte arritur të bëhej akcioner në shoqërinë mekanike "Partizani", ai rëfën se ka qënë për shumë vite inxhinier mekanik në këtë ndërmarrje shtetërore dhe se akcioner është bërë në vitet e para të demokracisë duke përdorur si gjithë akcionerët e tjerë privatizimin nëpërmjet letrave me vlerë.

KËRCËNIME DHE PEZULLIME

Vetëm 14 ditë pasi ishte bërë akcionere e shoqërisë mekanike "Partizani", Suzana Guxholli ndërmer hap të tjerë duke kërcënuar me pezullim të aktivitetit tregtar të kompanisë. Por përpara se të ndërmete këtë hap gjyqësor "Shqiptarja.com" mëson se ish-këshilltarja e Sali Berishës, Suzana Guxholli, kontaktonte në telefon administratoren e kompanisë Shqipe Doçi, duke i kërkuar takim. Ky takim është realizuar mes dy grave dhe se Guxholli ka kërcënuar administratoren me pezullim të aktivitetit të kompanisë në QKR, nëse ajo nuk i tregonte lidhur me dhurimin e shitjes e aksioneve nga ish-burri Besnik Pani. Pas këtij takimi, Guxholli ka arritur 14 ditë pasi është bërë pronare që të nxjerr një vendim nga gjykata e Tiranës duke pezulluar të gjithë aktivitetin e kompanisë dhe mos lejuar asnjë veprim shtesë në QKR. E kontaktuar në telefon administratoresha dhe njëherësh një nga akcionerët e shoqërisë mekanike "Partizani" Shqipe Doçi ka treguar se momentalisht kompania është pezulluar nga Suzana Guxholli. Sipas administratoresha në QKR nuk lejohen të dorëzohen as bilancet vjetore të kompanisë, pasi QKR i ka vendosur si kusht që asambleja e ortakëve të kompanisë të njohë si akcionerë të re Suzana Guxhollin. Doçi shton se QKR ka vepruar dhe vijon të veprtojë në kundërshtim me ligjin, dhe se për këtë janë në një proces gjyqësor dhe njëherësh kanë depozituar një kallëzim penal në prokurori kundër ish-drejtorit të QKR Tomi Kola. Nga ana tjetër "Shqiptarja.com" ka kontaktuar Suzana Guxhollin duke e pyetur rreth mënyrës se si ishte bërë një nga pronarët e shoqërisë mekanike "Partizani", Guxholli ka shtuar se: "... se ishte bërë nëpërmjet një vendimi gjykate për ndarjen e pasurisë dhe se kontratat e shitjes dhe dhurimit të aksioneve nga ish-burri kanë dalë të pavleshme...".

Skandali në jetimore, djali i drejtoreshës abuzoi me fëmijët


Dëshmia tronditëse: Djemtë na vinin te shikonim me zor filma porno

Dalin detaje të reja për skandalin e abuzimeve seksuale në Shtëpinë e Fëmijës në Shkodër. Një nga vajzat e abuzuara në këtë qendër ka pohuar përpara psikologut të Avokatit të Popullit se janë abuzuar seksualisht nga djali i ish drejtoreshës së kësaj qendre, Albana Llazani gjatë një ekskursioni. Në rekomandimin e Avokatit të Popullit drejtuar Prokurorit të Përgjithshëm Adriatik Lialla dhe prokurorit të Rrethit theksohet se gjatë një ekskursioni të organizuar në Velipojë dhe Razëm dy fëmijë të punonjëseve të kësaj qendre, të cilët duke qenë jashtë kontrollit kanë ushtruar dhunë fizike ndaj fëmijëve dhe në raste të tjera djali i drejtoreshës me iniciale B.L. ka ngacmuar seksualisht fëmijët e seksit femër me moshë më të vogël se ai. Pas konstatimit të abuzimeve nga ana e Avokatit të Popullit prokuroria ka nisur edhe një procedim penal, ku nga ekzaminimi dhe ekspertimi gjinekologjik rezultoi se tre fëmijë të kësaj qendre, përkatësisht të moshës, 6, 8 dhe 11 vjeçe janë abuzuar seksualisht.

SHIKONIN FILMA PORNO
Sipas burimeve të "Sh-



jetimotja në Shkodër



Albana Llazani

qiptarja.com" tre janë vajzat e abuzuara seksualisht 6, 8 dhe 11 vjeçe. Ata kanë dhënë dëshminë e tyre para bluve të Shkodrës duke theksuar se abuzimi ka ndodhur brenda institucionit të jetimores. Sipas dëshmisë së të miturave në qendër ka patur platforma dixhitale, dhe në shumicën e kohës ata rinin të vetëm në godinë dhe fëmijët më të mëdhenj i detyronin të shikonin filma erotik. Sipas tyre edukatore iknin nga qendra me orë të tëra.

DHUNA E EDUKATOREVE

Më tej në raportin e Avokatit të Popullit janë renditur edhe rastet e dhunës sistematike që ushtroheshin ndaj fëmijëve nga punonjësit social dhe edukatorët. "Nga edukatoret Rafaela Camaj dhe punonjësit të tjerë, është ushtruar dhunë fizike duke i rrahur me shkop druri të këmbëve të karrigeve, fëmijët e mitur si S. A., etj." - thuhet në këtë raport. Gjithashtu në këtë rekomandim raportohet edhe për sjellje diskriminuese ndaj

fëmijëve duke i detyruar për të kryer punë të ndryshme në qendër. "Në Shtëpinë e Fëmijës Shkodër, personeli manifeston sjellje qendërme diskriminuese ndaj fëmijëve të komuniteteve rome apo egjiptiane, veprim ky i konfirmuar nga deklaratimet e të miturit F.T. Nga edukatoret e Shtëpisë së Fëmijës në mënyrë flagrante janë lejuar fëmijët e mitur me moshë 10-12 vjeçe të lajnë korridorët dhe banjat e Institucionit, veprim ky që bie ndesh dhe me pikë 3 të nenit 54

të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë" - citohet në raport.

PRESIONI

Edhe pse kjo qendër ishte vendosur nën hetim dhe ish-in marrë dëshmitë e para nga fëmijët, drejtoresha e kësaj qendre Albana Llazani dhe punonjësit e tjerë nuk kanë hezituar të bëjnë presion dhe të kërcënojnë fëmijët që të mos tregojnë për abuzimin në këtë Shtëpi Fëmijës. Në rekomandimin e Avokatit të Popullit thuhet se pas inspektimit të kryer nga Ndihmëskomisionerët e Avokatit të Popullit më datë 19 Prill 2016, ata ishin thirrur nga edukatorët dhe drejtori i institucionit duke iu bërë presion për shpjegimet e dhëna. Ky qëndrim u reflektua edhe gjatë marrjes së shpjegimeve të nxënësve Xh.N në intervistimin e dytë.

ARRESTIMET

Pas konstatimit të këtyre abuzimeve, Avokati i Popullit ka kërkuar nga Prokuroria që të nisë menjëherë nisen e hetimeve dhe kryerjen e një ekzaminimi dhe ekspertimi gjinekologjik për fëmijët e mitur femra të ngacmuara seksualisht nga personi i dyshuar shtetas B.

Ll, si XH.K. etj. me qëllim kryerjen e hetimit dhe për vepra të tjera penale me objekt marrëdhëniet juridike të vendosura për të mbrojtur zhvillimin normal seksual e formimin moral të të miturave, që nuk kanë mbushur moshën 14 vjeç, apo kur nuk kanë arritur pjekurinë seksuale. Menjëherë pas këtij rekomandimi, prokuroria ka lëshuar urdhër ndalimi për Albana Llazani ish drejtoreshë e qendres rezidenciale të fëmijëve Shkodër, Rafaela Camaj edukatore, Shpresa Nishani, Najada Rramolli dhe violata marku personal kujdestar i kësaj qendre. Mbi 5 punonjëset e ndaluar rëndojnë akuzat e shpërdorimit të detyrës dhe keqtrajtim të të miturave.

REAGIMET PAS SKANDALIT

Drejtori i jetimores, Gëzim Mahmutaj, shprehet se organet kompetente po merren me hetimet. "Ka ndodhur një ngjarje tejte e shëmtuar për të cilën po hetohet. Unë s'mund të jap më shumë detaje se sa kanë dhënë organet kompetente. Shqetësimi jonë aktualisht është mbarëvajtja e punës në këtë institucion ku kujdesi për fëmijët është prioritet" - ka thënë ai.

OPINION

Kur shteti lë jetim të ardhmen e tij!



NGA JONIAIDA KOÇI

vijon nga faqja 1

E në atë moment një lëmsh m'u mblood në stomak e më pas në grykë, ndjesi që të gjithë ata që janë prindër, por në veçanti një nënë mund ta provojë e përjetojë. M'u kujtua vizita e vetme që kisha bërë para disa vitesh në Shtëpinë e Fëmijës "Zyber Hallulli" në kryeqytet.

Ajo që ma coptoi zemrën në atë vizitë për shkak të profesionit tim ishte dhimbja dhe vetmia që lexova në sytë e çdo vogëlushi aty. E prej asaj kohe mendoheja t'i shmangia kronikat në këto streha, pasi nuk doja ta përjetoja edhe njëherë atë ndjesi të trishtë. Por këtë nuk mund ta bësh për shumë kohë, aq më tepër kur në një vend si ky i yni dhimbja të del shpesh para syve, e madje të imponohet. Këtu një jetim nuk është thjesht i tillë në fatqeshinë e tij, për shkak të mungesës së prindërve, por është jetim edhe nga shteti.

Kësaj radhe monstruoze të njëzori goditi ato vajza të mitura, përkatësisht 6, 8 dhe 11 vjeçe. Kjo për shkak të neglizhencës së institucioneve tona. Për faj tuaj, ato vajza do të kenë pasojë të mëdha psikologjike, po për faj tuaj ato do ta kenë të vështirë ndoshta edhe të dashurohen me një mashkull. Po pra po, sepse ju lejoni "çunin e mamit të bukur" apo edhe të tjerë të hyjnë në institucion e të dalin me të ekskursioneve që vetë qendra organizonte sipas dëshirës, në çdo orë e në çdo moment. Po, po, faj juaj është që lejoni ato punonjëset të sëmura psikike të punojnë në një institucion të tillë e të abuzojnë me



ata fëmijë fatqeq.

Po pse, rasti i parë është ky? Jo, jo është një tjetër rast i përsëritur brenda pak muajve. Po çfarë bëte ju? Ç'bëte ju ndër vite për të luftuar këto raste, asgjë përveçse keni dalë e dilni vetëm për të trumbetuar se po punoni, dërgoni nëpër komisione ligje me pretekstin se po i përshtasni me ato europiane, merrni pjesë në tryza me ndërkombëtarë me pretekstin se po punoni për të gjetur mekanizmat për të luftuar

dhunën ndaj fëmijëve. Më thoni sa raste denoncimi raportohen dhe ç'masa keni marrë? Sa keni ndëshkuar ju? Këto streqëza si kontrollohen dhe sa herë e bëni këtë? Po këto punonjëse që i promovoni duke i bërë drejtoresha apo edhe edukatore, a i keni provuar për njohuritë e tyre? Përpara se t'i punësoni, a keni kontrolluar shëndetin e tyre mendor? A keni investiguar nëse këto kanë histori dhune familjare apo probleme

të ngjashme? A keni menduar se mjafton të shpenzoni shumë pak, duke vendosur kamera sigurie dhe shumë raste të tilla mund të ishin shmangur? Apo ato çënojnë privatësinë? Cilën privatësi? Atë të këtyre monstrave?!

Jo pra, asnjëherë nga këto s'keni bërë, prandaj abuzimi me fëmijët përsëritet hera-herës. Nuk keni si ta bëni, sepse në këtë vendin tonë edhe kujdestaret, ashtu si çdo nëpunës, punësohen në bazë miku, partie, e leku, e jo në bazë aftësish profesionale. A e dini çfarë?! Gjëja që dini ju të bëni më mirë është t'i hidhni fajin njeri-tjetrit e në fund ta lini atë jetim, si ata fëmijët atje në Shkodër, në Durres, apo kudoqoftë. E bëni këtë që të dilni të gjithë të larë nga histori që prodhohen përditë, përjavë, përmuaj vetëm e vetëm nga paaftësi juaj për të vepruar. Dilni e propagandoni e kërkoni anëtarësim në BE. Flisni për gjëra të mëdha, për reformë në drejtësi, në një vend ku prej vitesh e vitesh mungon drejtësia sociale e shtresat vulnerabel trajtohen si në një sistem skllavopronar. Ama një gjë e dini mirë: E ardhmja e një vendi janë fëmijët, të cilëve në fakt ju po ua vrisni çdo ditë e më shumë fëmijërinë.

Drejtori i kulturës: Shukriu në tre muaj më solli katër femra

Vajza: Ilva Tare më kërkoi të kryenim filmim tjetër. Kamerën ma montuan në kuletë

ELTON QYNO
TIRANË

Drejtori i qendrës së kulturës në Dibër Veli Vraniçi është një nga dëshmitarët e Prokurorisë së Krimeve të Rënda, në procesin gjyqësor që do zhvillohet kundër ish-kryebashkiakut të Dibërës Shukri Xhelili. Në dëshminë e dhënë në prokurori, Vraniçi ka rrefyer se shtetësja A.A është punësuar në dhjetëditëshin e tretë të muajit Mars 2016 si magazinierë në qendrën kulturore të Dibërës. Mirëpo në dëshminë e tij Veli Vraniçi tregon se në tre muajt e fundit me urdhër të Shukri Xhelilit janë punësuar në qendrën kulturore dhe katër femra si, A.A me detyrë magazinierë, S.V, punonjëse biblioteke, A.D, pastruese në muze dhe A.Sh. Në dokumentat që zotëron "Shqiptarja.com" evidentohet se vajza e përfshirë në këtë skandal seksual ka shkuar fillimisht tek "Ora Neës", duke takuar Ilva Taren dhe më pas kjo e fundit i ka ofruar mundësinë e bashkëpunimit që të filmonte përshëri Shukri Xhelilin deri në ambientet e hotelit. Vajza e skandalit tregon se i dhënë një kamera të vogël të cilën sipas saj ja kanë montuar në kuletën e saj.



Shukri Xhelili

DËSHMIA E DREJTORIT TË KULTURËS

Nëdhëkohë që në cilësinë e

- Faktikisht e dëshmisë së dëshmitarëve në prokurori

personit që ka dajeni për rrethana të dobishme për qëllime të hetimit më datën 13 maj 2016 në orën 10:15 është pyetur

2016 dhe A.D në muajin prill 2016. Drejtori shprehet se Qendra Kulturore Dibër disponon vetëm vendimet e emërimit të detyrë, por këto akte ndodhen në zyrën e financës, që administrohet nga financierja A.Sh, e cila nuk ndodhej në punë.

DËSHMIA E SHUKRI XHELILIT

Më datën 13 maj 2016 është pyetur kryebashkiaku Shukri Xhelili në cilësinë e personit ndaj të cilit zhvillohen hetimet. Në prani të mbrojtësit të tij, Xhelili lidhur me videon e transmetuar në "Tv Ora" shprehet se personi i shfaqur në video është A.A, punonjëse e bashkisë prej mëse tre muajsh dhe se ai ka njoheje me të prej më shumë se një vit. Ajo kjo është transmetuar në emision është një inskenim. Më tej, shprehet se deklarime do të japë pasi të njohë material hetimorë të dokumentuara për faktin.


PROVAT MATERIALE

Me vendim të datës 12 maj 2016 është urdhëruar sekuestri i provave materiale, kontrata e punës si dhe urdhëra të brendshme që lidhen me shtetasen A.A si e punësuar pranë bashkisë Dibër. Rezultoni se më datën 13 maj 2016 është sekuestruar vendimi nr.25 i shkurtit 2016 në ambientet e zyrës së menaxhimit të burimeve njerëzore pranë kësaj bashkie, në prani të përgjegjës Ilir Rabdishi. Ky vendim mban datën 26 shkurt 2016 dhe është nënshtruar nga Shukri Xhelili me statusin e kryetarit të kësaj bashkie dhe në pjesën vendosi ka këtë përmbajtje: "...Zonja A.A emërohet në detyrën e magazinieres pranë Qendrës Kulturore, Bashkia Dibër. Marëdhëniet financiare i fillojnë më datën 26 shkurt 2016. Të marrë në dorëzimin detyrën dhe të gjithë bazën materiale që ka në dispozicion...".

LAJME SHKURT

Eksperti: Fullani pësoi demë të parikuperueshme

Gjykata Administrative i jep fund procesit gjyqësor ndaj ish Governori Ardiyan Fullani që kërkon dëmshpërbim financiar me pretendimin se është shkarkuar padrejtësisht nga puna dhe ky shkarkim i ka shkaktuar atij një dëm psikologjik të parikuperueshëm. Më 26 Maj administrativja do të dëgjojë konkluzionet e palëve në proces e më pas do të dalë me një vendim, ndërsa juristët e bankës edhe këtë të enjte kërkuar rrezimin e padisë për dëmshpërbim nga Fullani. Vetë Fullani nuk ishte i pranishëm në gjykim ndërsa me padinë e tij depozituar pas pajafësisë së fituar në Apel ish Governori kërkon afro 500 mijë euro pagat e dëmi përfshi dha pagat e munguara nga shkarimi i padrejtë.



Dënohet me 2.4 vite burg prokurori Haxhi Gju

Gjykata e Krimeve të Rënda dënoi me 2.4 vite burg ish-prokurorin e Krujës Haxhi Gju dhe ish-kryeprokurorin i dosjes "Hajdari". Gju akuzohej për "korrupsionin aktiv i gjyqtarëve, prokurorit ose funksionareve të tjerë të drejtësisë". "Korrupsionin pasiv i gjyqtarëve prokurorit ose funksionareve të tjerë të drejtësisë". Ndërkaq i pandehuri tjetër në këtë çështje, Aleks Shpori, u dënua me 1.4 vite burg për akuzën e korrupsionit aktiv si dhe të ushtrimit i ndikimit të paligjshëm. Vendimi i dënimit u dha këtë të enjte nga Gjykata, një muaj pasi organi i akuzës kishte kërkuar dënimin e tij me 4 vite burg. Ndaj tij, gjykata dha masën e dënimin me 3.4 vite burg, por në zbatim gjykimin të shkurtuar të vijuar ndaj tij, Gju përfitoi afërsisht një vit ulje dënimi duke shkuar në 2.4 vite burg.

ARRESTIMI/ ISH-HIOTEKUESI TJETËRSO I DËNORIN E MANASTIRIT TË ARDENICËS Prokuroria e Lushnjës arreston dhe pronarin e kompleksit privat

Me kërkesë të Prokurorisë së Lushnjës, gjykata ka vendosur masën e sigurisë për ish-drejtesit e Hipotekës së këtij qyteti, si edhe të një pronari biznesi, të dyshuar për "Fallsifikim dokumentash" në bashkëpunim,

në vijim të një hetimi të nisur nga kallëzimi i dorëzuar nga përfaqësuesit fetarë të Manastirit të Ardenicës. Nga hetimi i deritanishëm i Prokurorisë së Lushnjës, rezultoi se përfaqësuesit e Manastirit, gjatë një procesi gjyqësor civil, kanë

konstatuar se një pjesë e pronës të cilën e pretendonin, më konkretisht rreth 6300 m2, ishte e regjistruar në emër të shtetasit A.Lushi, pronar i një kompleksi shërbimesh në zonën e Ardenicës. Sapo kanë konstatuar këtë situatë, për-

faqësuesit e Manastirit kanë dorëzuar një kallëzim penal në Policinë e Lushnjës, e cila ia referoi më tej Prokurorisë. Në bazë të hetimeve, Prokuroria e Lushnjës ka arritur të evidentojë se, në vitin 2014, prona e pretenduar nga Manastiri, është regjistruar në Zyrën Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (ZVRPP) në emër të shtetasit A.Lushi, në bazë të dokumentave të fallsifikuar. Po ashtu, nga veprimet hetimore të Prokurorisë së Lushnjës, janë krijuar dyshimet e arsyeshme se kjo pronë është regjistruar në bazë të urdhërave verbalë të Kryetarit të ZVRPP në atë kohë, shtetasi B.Koçiu. Nga të dhënat hetimore të përfituara deri në këtë fazë të hetimit, Prokuroria e Lushnjës krijoi dyshime të arsyeshme se prona e pretenduar në një proces civil nga përfaqësuesit fetarë të Manastirit të Ardenicës, është regjistruar



në bazë të dokumentave të fallsifikuar nga ana e ish-drejtesit të ZVRPP, B.Koçiu, si edhe nga pronari i kompleksit privat të shërbimeve, A.Lushi. Ndaj këtyre dy persona u kërkuu caktimi i masës së sigurisë "arrest në burg", e cila u pranua nga gjykata. Në zbatim të vendimit të Gjykatës së Lushnjës, forcat e Policisë së Shtetit arrestuan dy personat e dyshuar.

PROCESI NË DURRËS

Rrëzohet kërkesa për ekstradimin e "Ben Çamit"

Gjykata e Durrësit ka rrëzuar kërkesën e drejtësisë italiane për ekstradimin e Lutfi Shabanit, i cili njihet me nofkën Ben Çami. Avokati mbrojtës i të pandehurit, Detar Hys, u shpreh pas seancës se Gjykata vlerësoi kërkesën mbi ligjshmëri dhe me objektivitet. Ai akuzohej për trafik ndërkombëtar droge. Ben Çami u arrestua në 26 shkurt të këtij viti gjatë një operacioni antidroge në Kapshticë ku u kapën 574 kg lëndë kanabis sativa. Ben Çami është një nga personazhet e njohur të botës së trafikut, dhe një nga njerëzit e afërt me Emiljano Shullazin.



Lutfi Shabanit (Ben Çami)

Shtyhen deri në fund 2017 afatet për tokat bujqësore

Ndryshojnë ligjet për titujt e pronësisë në fshat

Kanë mbërritur në Kuvendin e Shqipërisë dy projektligje, të kaluara tashmë në shqyrtim nga ana e Ekzekutivit, që zgjatin edhe një vit e gjysmë afatet për kalimin e tokës bujqësore të ish-ndërmarrjeve shtetërore dhe ish-kooperativave të para viteve '90 tek përfuttes të tjerë.

Ligji nr.171/2014, "Për përfundimin e procedurave të kalimit të tokës bujqësore të ish-ndërmarrjeve bujqësore në pronësi të përfuttesve", që ndryshohet meklëtë rast, synon përfundimin e procedurave ligjore të kalimit në pronësi pa shpërbllim të tokës bujqësore të ish-ndërmarrjeve bujqësore përfuttesve, të cilët nuk kanë bërë kalimin në pronësi.

Procesi i plotësimit të dokumentacionit të pronësisë mbi tokën bujqësore, për territoret e ish-ndërmarrjeve bujqësore kryhet nga bashkitë. Për rastet kur komisioni i ndarjes së tokës, ka ndarë tokën bujqësore, por nuk ka plotësuar aktet e marrjes së tokës në pronësi, ligji ngarkon kryetarët e bashkive, t'i plotësojnë ato, në përputhje me kriteret dhe procedurën e përcaktuar në këtë ligj dhe aktet nëligjore në zbatim të tij.

Por problemi ndërlikohet nga reforma administrative. Bashkitë e reja, të cilat dolën nga zgjedhjet lokale të vitit 2015, në vijim të punës së filluar nga komunat e bashkitë e mëparshme, po punojnë për realizimin e këtij procesi. Mospërfundimi i tij në afatet e planifikuara, ka ardhur për shkak të mosnjohjes së tij nga administrata e re, përgatitjes së kapaciteteve njerëzore dhe të bashkëpunimit të mjaftueshëm me institucionet e tjera shtetërore. Aktualisht rezultoni që janë miratuar vetëm një numër i vogël titujsh pronësie. Ndërsa një numër bashkish ndonëse kanë nisur procesin, ende janë në fillim të tij. Nëse ky afat nuk do të shtyhet, pra procesi nuk përfundon në rrugë administrative, përfuttesit do të detyrohen t'i drejtohen organeve gjyqësore (kjo e drejtë është e parashikuar në ligj) por do të ketë më tepër kosto për ta. Kështu, propozohet që afati i përfundimit të këtij procesi të jetë në datën 31 dhjetor 2017.

Po kështu, zgjatet deri në fund të vitit të ardhshëm edhe afati për të shqyrtuar me procedurë të përsheptuar dhe përfunduar procesin e plotësimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore, për territoret e ish-kooperativave bujqësore, nga bashkitë, si



SHTYRJA

75% e kërkesave të paraqitura në gjykatë për pavlefshmëri të titujve të pronësisë s'janë shqyrtuar ende nga gjykatat e të gjitha shkallëve. Afati i përfundimit të këtij procesi propozohet 31 dhjetori 2017

Lojrat e fatit

Bastet sportive, ndryshon procedura e adresave sekondare

Ndryshime të reja parashikohen në aktivitetin e lojërave të fatit. Me një Udhëzim të ministrit të Financave, tashmë shoqëritë e lojërave të fatit të licencuara në kategorinë e basteve sportive do të lejohen të hapin adresa sekondare, por sipas një procedure regjistrimi të rinovuar.

Ato duhet të paraqesin në Au-

toritetin e Mbikëqyrjes së Lojërave të Fatit (AMLF) dokumentacionin e mëposhtëm: Kërkesë për hapjen e pikave dhe adresën e saktë të saj; Kopje të letërnjoftimit dhe kontratës së punës për punonjës, i cili do të jetë i punësuar në këtë pikë; Miratimin paraprak të marrë në AMLF nga pronari i ambientit në të cilin do të

ushtrohet aktiviteti i lojërave të fatit, sipas përcaktimeve të nenit 3, të ligjit nr. 155/2015, "Për lojrat e fatit në Republikën e Shqipërisë"; Kopje e njësuar me originalin e kontratës së qirasë/huapërdorjes, hartuar e nënshkruar përpara noterit, bashkëlidhur certifikata/vërtetimi i pronësisë apo dokument tjetër që provon të drejtën e qiradhenësit/huadhënësit për të poseduar dhe gëzuar ligjërisht ambientin e dhënë me qira apo në huapërdorje; Vërtetimi nga organet tatimore për shlyerjen e detyrimeve tatimore. Për punonjës, i cili do të jetë i punësuar në këtë pikë shoqëria duhet të zotërojë në dosjen e personelit, në selinë e shoqërisë, dokumentacionin e poshtëshënuar: kopje e letërnjoftimit; vërtetimi i gjendjes gjyqësore; dëshmi kualifikimi; kontratë pune.

Po ashtu, Udhëzimi, i cili ka hyrë në fuqi, rregullon edhe procedurën e mbylljes së adresave sekondare, nga ana e shoqërive të lojërave të fatit të licencuara në kategorinë e basteve sportive.

Nevojiten dokumentat: Njoftim për mbylljen e sallës; Dokument që vërteton zgjidhjen e kontratës për ambientet e marra me qira. Udhëzimi i ri i Ministrisë së Financave gjithashtu bën të ditur se shoqëritë e lojërave të fatit nuk mund të ushtrojnë veprimtarinë në një pikë të caktuar pa marrë miratimin me shkrim nga Mbikëqyrja e Lojërave të Fatit



DETYRIMI

Udhëzimi i ri i Ministrisë së Financave bën të ditur se shoqëritë e lojërave të fatit nuk mund të ushtrojnë veprimtarinë në një pikë të caktuar pa marrë miratimin me shkrim nga Mbikëqyrja e Lojërave të Fatit

dhe të procesit të shqyrtimit të vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore, nga komisionet vendore të vlerësimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore, pranë prefektëve të

do qarku. Afati, aktualisht, mbaron në 30 qershor 2016 dhe është propozuar të shtyhet deri në dhjetor 2017. Në këto kushte është propozuar edhe shqyrtimi i këtij projektligji me procedurë të përsheptuar.

Nga raportimet e komisioneve vendore rezultoi se gjatë gjithë veprimtarisë, deri më 31 dhjetor 2015, janë paraqitur 18.500 kërkesa nga qytetarët dhe institucionet shtetërore. Nga të cilat, 10.065 kërkesa


janë mbyllur me përgjigje administrative dhe për 3.482 kërkesa janë marrë vendime administrative. Rezultoni se ka ende një numër shumë të madh kërkesash që duhet të shqyrtohen, rreth 5.000.



Mbledhje Qeverie

QEVERIA

Anulohet zona ekonomike në Lezhë, shkak pronësia



Qeveria ka miratuar në mbledhjen e fundit revokimin e vendimit të vitit 2009 për shpalljen e zonës ekonomike në Lezhë. Shkak për këtë revokim ishin problemet e pronësisë, që kishin larguar edhe ata investitorë, të cilët kishin shfaqur interes. Nga sipërfaqja totale 34.6 ha ishte shtetërore dhe 21,3 ha ishte private. Sipas ministrit të Ekonomisë, riaktivizimi i zonës së mësipërme, për shkak të problematikave të pronësisë së truallit, nuk mund të vazhdojë, sepse së pari do të kërkonte një konfigurim të ri të kësaj sipërfaqeje, ndryshimin e statusit të zonës dhe shpronësimit të sipërfaqeje me pronësi private, gjë e cila do të kishte kosto financiare. Vendimi për shpalljen e zonës ekonomike me statusin "Park industrial", në Lezhë u mor në vitin 2009 dhe jepte me koncesion rreth 55 ha për 35 vjet. Llojet e veprimtarisë, që parashikoheshin të zhvilloheshin në këtë zonë ishin: veprimtari prodhuese, industriale dhe agropërpunim; veprimtari tregtare, import-eksport; shërbime.



HIDROKARBURET / ARSYE, INTERESAT E SIGURISË KOMBËTARE

Koncesionet, shteti mund të mos miratojë një shitje license

Ministria e Energjetikës ka bërë gati disa ndryshime në ligjin për kërkimin dhe prodhimin e hidrokarbureve, nëpërmjet të cilit janë futur disa koncepte të reja që kanë të bëjnë me sigurinë kombëtare. Në rastet kur dega në Shqipëri është u transferuar nga një e parë, tek një tjetër, projektligji i ri parashikon që shteti shqiptar të ketë të drejtën që, për shkak të sigurisë kombëtare, mund të mos e miratojë një kalim license koncesionare. Projektligji gjithashtu kufizon trajtimin fiskal të koncesionarëve, nga 35 vite që është aktualisht, afërsisht sa kohëzgjatja e koncesionit, në 10 vite.

Ndryshimet gjithashtu realizojnë një ndarje më të qartë e afateve kohore që përfshihen në periudhën e kërkimit me atë të vlerësimit të një zbulimi (7 vite kërkim dhe 3 vite vlerësim).

Burimet nga Ministria e Energjetikës pohuan se me rritjen e stabilitetit të Republikës së Shqipërisë, kalohet nga përfshirja në Marrëveshjet Hidrokarbure të klauzolare të hapura dhe të pakufizuara në kohë lidhur me stabilitetin e regjimit fiskal në aplikimin e tyre në një afat kohor të kufizuar (10 vjet nga data e fillimit të prodhimit të hidrokarbureve).

Përcaktohet që aktiviteti i kërkimit dhe prodhimit të lëndëve hidrokarbure të kryhet nga ekspertë të pajisur me certifikatën e lejes profesionale për veprimtarinë studimore-projektuese dhe zbatuese për kërkimin dhe prodhimin e naftës dhe të gazit.

Sa i përket lehtësirave fiskale lidhur me koncesionet hidrokarbure, ato do përcaktohen sipas klauzolare të legjislacionit tatarim në fuqi.




Pronarët

Ja formulari i kërkimit të pronave, afat 23 maji

Janë ende 8.630 përfaqësues pronarësh, të cilët kanë dosje në shqyrtim, por po mbaron koha për kërkesat që ende nuk janë bërë

Agjencia e Trajtimin të Pronës njoftoi se ish-pronarët, të cilët ende nuk kanë regjistruar kërkesën e tyre për kthim fizik apo kompensim financiar të pronës, duhet të plotësojnë një formular tip, si dhe të paraqesin dokumentet që provojnë pronësinë mbi pronën e pretenduar në Agjencinë e Trajtimin të Pronave për të përfutur kthimin apo kompensimin e pronës.

Formulari merret në Agjencinë e Trajtimin të Pronave dhe dorëzohet i plotësuar dhe i shoqëruar me dokumentet përkatëse dorazi ose me postë. Sipas legjislacionit në fuqi, subjekti i shpronësuar, trashëgimtarët e tij ligjorë ose përfaqësuesi i tyre me prokurë, depoziton në Agjencinë e Trajtimin të Pronës, drejtpërdrejt ose nëpërmjet postës, kërkesën e motivuar për njohjen dhe kompensimin e pronës, shoqëruar me dokumentacionin e nevojshëm, sipas këtij vendimi, me të cilin provon pretendimet e tij.



Turizmi

Përcaktohen kriteret për marrjen e plazheve në përdorim

Qeveria me një vendim të miratuar në vitin 2014 përcaktoi se 20% e plazhit në vijën bregdetare do të jetë publik, ndërsa 80% jepet për shfrytëzim nga privatët. Vendimi i miratuar të mërkurën në qeveri përcakton se të gjithë personat fizikë apo juridikë që duan të ushtrorjnë aktivitetin e stacionit të plazhit duhet të bëjnë kërkesën pranë njësite vendore. Avantazh kanë ata që kanë eksperiencën e mëparshme në ushtrimin e veprimtarisë së stacionit të plazhit dhe/ose veprimtarive të tjera turistike në plazh dhe dorëzimi i një plani biznesi që përmbush standardet minimale për ruajtjen e bregdetit dhe natyrës, pastrimin e hapësirës së plazhit dhe sigurisë së pushuesve, thuhet në vendim. Përparësi kanë edhe ata që kanë strukturë të ngritur që ushtron aktivitet pranë plazhit, pra bar--restorant apo hotel. Pushteti vendor jep miratimin e parë për lidhjen e kontratës me afat njëvjeçar, me të drejtë rinovimi për një periudhë 3 vjeçare, por vendimtar do të jetë një raport monitorimi nga Agjencia e Bregdetit.

DOKUMENTAT

Pronarët ose trashëgimtarët e tyre duhet të paraqesin vetëm dy dokumente: një dokument arkivor të njohur zyrtarisht dhe një pozicionim hartografik të pronës që pretendohet për njohje pronësie

rreme apo depozitimit të dokumentacionit të falsifikuar.

AFATI KOHOR

Pronarët të cilëve u është marrë toka në vitet e para të komunizmit dhe nuk kanë aplikuar ende për njohjen dhe kompensimin e pronës, kanë afat deri në 23 maj për të aplikuar në Agjencinë e Trajtimin të Pronave.

DOKUMENTACIONI

Pronarët ose trashëgimtarët e tyre duhet të paraqesin vetëm dy dokumente: një dokument arkivor të njohur zyrtarisht dhe një pozicionim hartografik të pronës që pretendohet për njohje pronësie. Dokumentet duhet të paraqiten në zyrat e Agjencisë së Trajtimin të Pronave ose në postë në adresë të agjencisë.

FORMULARI TIP

APLIKIM PËR TRAJTIMIN E KËRKESAVE PËR NJOHJE TË PRONËS DHE KOMPENSIMIT TË SAJ

Drejtuesi: _____

Data e paraqitjes së kërkesës: _____

Emri/latësi/mbiemri i subjektit që paraqet kërkesën: _____

Adresa: _____

Nr. i identifikimit personal: _____

Emri/latësi/mbiemri i subjektit të shpronësuar: _____

Kërkesa është për (shëno brenda kadrave):

1. Njohje pronësie kompensim fizik në pronën e njohur / kompensim:

Tërësisht Nënmasë Të një pjese Pjesërisht/totalisht

2. Vendime të marra:

Rishqyrtim të vendimit të mëparshëm Shqyrtim/kërkesë e re

Bashkëlidhur dokumentacioni si më poshtë:

1. Dëshmi trashëgimie _____

2. Prokurë e Përgjithshme Poasme _____

3. Dokumenta ligjor _____

4. Vendime të ish - IKKJP/ZAKKP/AKKP _____

● Faksimile e formularit tip të kërkesës për ish-pronarët

Kërkesa e subjektit të shpronësuar, trashëgimtarëve të tij ligjorë ose përfaqësuesit me prokurë, duhet të jetë sipas formularit tip, i cili publikohet në këtë faqe, për aplikimin e kërkesave për njohje e kompensim, i cili duhet të jetë i nënshkruar nga subjekti

i shpronësuar ose përfaqësuesi i tij me prokurë. Formulari-tip përmban një paralajmërim, që ngarkon me përgjegjësi sipas ligjit subjektin kërkues, në rast të deklarimit të të dhënave të

DOSJET

Sipas njoftimit zyrtar nga Agjencia e Trajtimin

të Pronës, deri tani janë njoftuar zyrtarisht 8.630 përfaqësues pronarësh, të cilët kanë dosje në shqyrtim pranë Agjencisë, për të cilat ende nuk ka një vendim-marrje zyrtare. Aplikuesve në njoftimin e bërë iu bëhet e ditur se ka nisur shqyrtimi administrativ i dosjeve dhe, nëse kanë dokumentacion plotësues për vërtetimin pronësie, ata janë të ftuar ta paraqesin këtë dokumentacion pranë kësaj Agjencie.

Mali i Zi, anëtar i 29-të i Aleancës së Atlantikut

Fqinji ynë u bombardua nga avionët luftarakë të NATO-s 16 vite më parë, pjesë e Jugosllavisë

NATO ftoi zyrtarisht shtetin ballkanas të Malit të Zi, të bëhet anëtar i 29 i aleancës, duke nënshkruar këtë të enjte zgjerimin e 7 në historinë e saj, pavarësisht kundërshtimeve të ashpra të Rusisë. Vendimi është ende subjekt i miratimit formal nga Senati amerikan dhe parlamentet e vendeve tjera anëtare të NATO-s. Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg tha se "ky ishte vetëm fillimi i një kapitulli të ri të sigurisë" në historinë e ish-republikës jugosllave.

Kryeministri malazez, Milo Gjukanović ishte pjesëmarrës edhe në nënshkrimin e protokollit të pranimit të vendit të tij në selinë e NATO-s në Bruksel. Ai tha se vendi i tij, i bombarduar nga avionët luftarakë të aleancës 16 vite më parë, duhet të qëndrojë "krah me krah" me vendet e tjera anëtare të aleancës së udhëhequr prej Shteteve të Bashkuara. "Mund të mbështeteni te ne në çdo kohë", tha Gjukanović.

Rusia e ka akuzuar aleancën atlantiko-veriore se po përpiqet të rrethojë atë dhe

NATO

Që prej krijimit të NATO-s, në vitin 1949, si një mburojë e Luftës së Ftohtë kundrejt Bashkimit Sovjetik, Aleanca tashmë është zgjeruar, nga 12 vende themeluese, në 29, duke thithur edhe nga ish-blokun komunist



kombet aleate të Moskës, si Serbia, si dhe është angazhuar se do të bëjë gjithçka të nevojshme për të mbrojtur sigurinë e saj kombëtare dhe interesat e saj. Sergei Zheleznyak, një deputet i shquar i Parlamentit rus, tha se vendit të tij do t'i duhet të alternojë marrëdhëniet e saj me Malin e Zi, historikisht aleat i Rusisë, tashmë që vendi ballkanas do t'i bashkohet NATO-s pa zhvilluar më herët një referendum kombëtar. "Ne duhet të ndryshojmë politikën tonë kundrejt këtij vendi mik", tha Zheleznyak. "Nëse infrastruktura ushtarake e NATO-s do të

Kosova

Kongresi i Shteteve të Bashkuara i ka kërkuar administratës së presidentit Obama të procedojë për integrimin e Kosovës në NATO. Pritet që Forca e Sigurisë së Kosovës të kthehet në ushtri reale



vendoset atje, ne do të duhet të përgjigemi duke kufizuar kontaktet tona në fushat ekonomike por edhe të tjera". Ndërkohë, zyrtarë të tjerë rusë kanë thënë se Moska duhet të ndalojë disa importe nga Mali i Zi dhe të vendosë sanksione të tjera tregtare. Ceremonia e nënshkrimit në selinë e NATO-s, për ftësen për anëtarësim të Malit të Zi, koïncidoi me fillimin e një takimi të ministrave të Jashtëm të aleancës, ndërkohë që edhe Sekretari amerikan i Shtetit, John Kerry e nënshkroi dokumentin në emër të Shteteve të Bashkuara.

Që prej krijimit të NATO-s në vitin 1949, si një mburojë e Luftës së Ftohtë të Perëndimit kundrejt Bashkimit Sovjetik, tashmë është zgjeruar nga 12 vende themeluese deri në anëtarin e 29, duke thithur në vetvete edhe shumicën e ish-aleatëve të Kremlinit në ish-blokun lindor komunist. Të fundit që janë anëtarësuar në NATO kanë qenë Shqipëria dhe Kroacia, në vitin 2009.

KOSOVA

Ndërkohë, Kongresi i Shteteve të Bashkuara i ka kërkuar administratës së presidentit Obama të procedojë me ndihma konkrete të gjithanshme që bëjnë të mundur integrimin e Kosovës në NATO. Kjo kërkesë përbën një hap të rëndësishëm për Kosovën dhe sigurinë e saj, e cila fillimisht duhet të bëhet pjesë e Partneritetit të Paqes të Aleancës.

Ndërkohë, pritët që së shpejti Forca e Sigurisë së Kosovës të kthehet në ushtri, proces ky që është vonuar për shkak të krizës politike që ka përfshirë vendin.

KORRUPSIONI

Svetozar Marović, që shër-



beu si president i shtetit të përbashkët të Serbisë dhe Malit të Zi deri në ndarjen e tyre, ka nënshkruar një marrëveshjeje me prokurorët që e akuzojnë për përfshirje në një seri rastesh korruptive, përmes të cilës ka marrë përsipër përgjegjësinë por edhe lirin nga burg. Sipas avokatit të Marović, Zdravko Begović, klienti i tij ka firmosur një marrëveshje përmes të cilës pranon fajin për një çështje për marrje rryshfeti. Megjithatë, Begović nuk ka dhënë detaje për marrëveshjen në fjalë, me argumentin se përbën sekret hetimor. Marović u arrestua në dhjetor të vitit 2015, i fundit i një serie arrestimesh ku u përfshinë bashkëpunëtorë

dhe familjarë të tij. Autoritetet malazeze vunë në pranga 13 persona, përfshirë vëlain e Marović, njëkohësisht sekretarin e atëhershëm të investimeve në Budva, Dragan Marović; si dhe vajzën e tij, Milena Bogdanović. Ata akuzoheshin për marrëveshje fiktive me kompani private ndërtimi, veprime që sipas autoriteteve kanë dëmtuar buxhetin vendor të qytetit të Budvës me mbi 10 milionë euro.

Prokurori i posaçëm për hetimin e Krimit të Organizuar, Milivoje Katnić deklaroi se hetimi i këtyre rasteve ishte edhe më i gjerë dhe arrinte tek vetë Svetozar Marović, i cili në fund të vitit të kaluar u vu në pranga.

KATASTROFA/ NUK PËRJASHTOHET SI SHKAK TERRORIZMI

Rrëzohet në detin Mesdhe avioni i linjave egjiptiane

Një avion i kompanisë ajrore të Egjiptit është rrëzuar, sipas të gjitha gjasave, në detin Mesdhe. Sipas burimeve pranë shtabit që udhëheq operacionin e kërkimit, siç transmeton edhe televizioni shtetëror "ERT", 230 milje në Juglindje të Kretës, brenda zonës detare dhe ajrore të Greqisë janë gjetur dy objekte në ngjyrë portokalli, të cilat vlerësohen se janë pjesë të avionit të zhdukur. Ky lajm vjen vetëm disa minuta pas deklarimit për shtyp të Shërbimit të Avionit Civil të Greqisë, sipas të cilit "Airbus A320" i kompanisë egjiptiane që fluturonte nga Parisi me destinacion Kajron, ka humbur nga radari në momentin kur ndodhej 7 milje brenda zonës ajrore të Egjiptit, ndërsa si vend ku mund të jetë rrëzuar përcaktohet pjesa jugore detare pranë ishullit Karpatos të Greqisë, jo shumë larg vendit ku janë gjetur edhe objektet që mund të jenë pjesë të avionit.



është bërë në orën 02:48 të mëngjesit (me orën greke), 24 minuta pasi kishte hyrë në zonën ajrore të Greqisë, e gjatë komunikimit nuk ka pasur ndonjë referim për ndonjë problem të avionit, madje piloti ka falënderuar edhe në greqisht palën greke. Në orën 03:27, qendra e kontrollit në Athinë është përpjekur të komunikojë përsëri me pilotin e avionit në fjalë, por nuk ka marrë asnjë përgjigje për dy minuta rresht, deri sa humbi

edhe sinjalin në radar, teksa menjëherë aktivizohet gjendja e gatishmërisë për operacionin e kërkimit, duke u lajmëruar edhe autoritetet e Kajros. Përveç këtij komunikimi të Shërbimit të Avionit Civil grek, tashmë të gjitha mediet e huaja dhe specialistët analizojnë deklaratën e ministrit grek të Mbrojtjes, pak çaste më parë, sipas të cilit avioni në fillim ka kryer një kthesë prej 90 gradësh majtas, e pak më vonë një

rrotullim prej 360 gradësh djathtas, duke rënë nga një lartësi prej 37.000 këmbësh në 8.000 këmbë. Fakti se, përse gjatë të gjithë kësaj kohe piloti nuk ka mundur të komunikojë dhe të thotë diçka, lind dyshime se diçka ka ndodhur në kabinën e pilotëve dhe kjo është një prej pistave që diskutohet më shumë. Ndërkohë, është në zhvillim një operacion gjigant kërkimi, ku marrin pjesë Greqia, që në momentet

e para me fregatën "Nikiforos Fokas", disa anije të tjera në zonë, dy avionë "C130", një avion tjetër i tipit "EMB-145 H", si dhe dy helikopterë: "Super Puma" dhe "S-70". Përveç një dëshmie të një kapiteni anijeje mallrash, që ka para një shkëlqim në qiell rreth 130 milje në Jugperëndim të ishullit Karpatos, edhe një pilot i një fluturimi në kah të kundërt në atë orë ka dëshmuar se ka parë në atë zonë një ndriçim të madh në det.

DRUGA

Përleshje masive mes të burgosurve shqiptarë dhe anglezë

Një përleshje masive mes të burgosurve shqiptarë dhe atyre anglezë për kontrollin e shpërndarjes së drogës në një burg anglez është raportuar nga tabloidi britanik "Daily Mail". Skenat filmike të marra nga kamerat e sigurisë së burgut Wandsworth, në jug të Londrës, janë brutale. Përleshja ka ndodhur në kohën e ajrosjes, kur të burgosurit kanë qenë në oborrin

e burgut. Grupet janë përleshur duke goditur me grushta e shkelma njëri-tjetrin, ku dukshëm një grup është më i madh në numër. Nuk dihet nëse shqiptarët apo anglezët kanë më të shumtë në numër, por në burgjet angleze e sidomos në Londër, prania e të dënuarve shqiptarë është i konsiderueshëm. Një nga të lënduarit nga kjo përleshje masive fizike është

dërguar me helikopter në spital dhe është jashtë rrezikut për jetën. Nuk dihet koha e saktë se kur ka ndodhur përleshja, por mendohet që ajo të jetë verifikuar së fundmi. Shtypi së fundimi ka njoftuar se një ndër dhjetë të burgosur në burgjet angleze është i huaj dhe një numër mjaft i madh i tyre janë shqiptarë, siç deklaroi dhe ministri britanik i Drejtësisë, Michael Gove.



Ylli POLOVINA
TIRANE

SHKRIMI I PARË

Në 17 nëntor 1980 i Ngarkuari me Punë i Shqipërisë në Francë, Kujtim Hysenaj, i dërgoi Tiranës që nga selia e përfaqësimit diplomatike në Paris, "Rue de la Pompe", numri 131, një paketë shkresore të shoqëruar me një letër përcjellëse.

Kjo e fundit e kishte numrin e protokollimit 401.

I drejtohej ministrit të Jashtëm Nesti Nase dhe ra në duart e këtij të fundit dy ditë më pas, në 19 nëntor.

Teksti i letrës shoqëruese që ky: "Bashkëngjitur ju dërgojmë dokumentet mjekësore të shokut Hysni Kapo, të cilat u tërhoqën nga ana e jonë në spitalin "Broussais", ku ishte shtruar. Mendojmë se këto dokumente kanë vlera arkivale, për këtë qëllim u tërhoqën nga arkiva e spitalit të sipërmë".

Shënimi mbi letrën përcjellëse "Mendoj të dërgohen me shkresë në K.Q.P.", pra në Komitetin Qendror të Partisë së Punës të Shqipërisë, datuar më 19 shtator 1980, të lë përshtypjen e parë se kjo procedurë është mbyllur me rrugën nisëse Ambasada Shqiptare në Paris dhe mbërritëse në Tiranë: selia e KQ të PPSH-së.

Mirëpo për afro dy vite, deri në 22 korrik 1982, dosja e plotë mjekësore e Hysni Kapos, e marrë prej spitalit parisian "Broussais", ku ai u kurua dhe ndërroi jetë në 23 shtator 1979, qëndroi në arkivin e Ministrisë së Punëve të Jashtme.

Nesti Nase, titullari i këtij institucioni, edhe pse një shkresë për përcjelljen e pakos dokumentare për në Komitetin Qendror të Partisë së Punës të Shqipërisë u bë gati nga administrata vartëse, nuk u firmos kurrë prej tij.

Enigma e këtij qëndrimi si edhe një grumbull i tërë ngjarjesh të tjera, një pjesë e tyre shumë e hetuar dhe e debatuar në median tonë, mund të ndriçohet sadopak në rast se depërtojmë nëpër shtigjet e të së vërtetës historike dhe krahas saj, të intrigës politike që është luajtur mbi atë trup të pajetë.

Në jetën e Shqipërisë së pas Luftës së Dytë Botërore manipulimi mbi mënyrën e vdekjes së një udhëheqësi komunist, ku patjetër do të ketë elemente të vrasjes, në rastin e Mehmet Shehut është kulmor dhe të Nako Spiros tepër e ngulitur në kujtesën e opinionit tonë publik. Ndërsa në rastin e dytë vetëvdekja me vrasjen ndahen në mënyrë të barabartë, në atë të kryeministrit shqiptar ka pothuaj katër dekada ku përkrahësit e tezës së likuidimit të dhunshëm fizik janë në hegjemoni të plotë.

Vdekja e Hysni Kapos mban vendin e tretë në përmasën e debatit nëse është apo jo jetëshumbje natyrore.

Mes atyre që e shtyjnë interpretimin e vdekjes së tij si vrasje, madje më aktivët protagonistë, gjenden në rrethin e ngushtë të familjarëve.

Duke filluar nga e shoqja, partizania e vjetër Vito.

ENVER HOXHA MES VDEKJES SË MEHMET SHEHUT DHE TË HYSNI KAPOS

Në vjeshtë të vitit 1982 në të gjitha qytetet e Shqipërisë, në sallat më të mëdha që kishin, u mblohdën kuadrot dhe veprimtarët më të shumtë të partisë-shtet dhe u lexua një material i posaçëm, ku Enver Hoxha përsëriti me këmbëngulje se i duhej dhënë fund njëherë e përgjithmonë dyshimit se Hysni Kapo nuk pati vdekur prej një sëmundjeje të pashërueshme, por si pasojë e një vrasjeje nëpërmjet kurimit mjekësor.

Kur formuloi dhe shpërnda këtë ndërhyrje të tij ai nuk mund ta dinte se edhe për të, pas ndërrimit jetë, do të ndodhte e njëjta gjë. Edhe këtë herë burimi që do ta pluskonte në sipërfaqe të ndjeshmërisë së opinionit publik vendas do të qenë pjesëtarë të rrethit shumë



Hysni Kapo jetëndërruar gjatë funeralit të organizuar në Tiranë

MISTERI I VDEKJES DYZETË VITE KONSPIRACION MBI VDEKJEN E HYSNI KAPOS

Dosja mjekësore që erdhi nga Parisi dhe Nesti Nase e mbylli në arkivin e Ministrisë së Punëve të Jashtme.



Hysni Kapo

të ngushtë familjar. Por pa mundur dot të krijojnë një grup ndjekësish, sado të vogël.

Në letrën e tij pothuaj urdhëruese Enver Hoxha kërkoi prej të gjithëve që të largonin nga mendja idenë se në fatin e Hysni Kapos kishte pasur ndikim një ndërhyrje e huaj agjenturore.

Autori i këtij shkrimi, ato kohë drejtor i pallatit të kulturës "Tekstilisti" në Berat, ka qenë i pranishëm në një mbledhje të tillë.

Sipas ditarit të Enver Hoxhës, ditën e hënë, në 27 shtator 1982, pa dy ditë plotësisht në tre vjetorin e vdekjes së Hysniut, shënohen këto fjalë: "Thirra Vito Kapon dhe i tërhoqa vëmendjen për çështjen se është përhapur në të gjithë vendin tonë sikur shokun Hysni Kapo e kanë vranë dhe nuk paska vdekur nga kanceri. Kjo thënie nga dikush duhet të ketë dalë, i vura në dukje Vitos, por unë sot po të qortoj se ke qenë vetë ti që ke ardhur tek unë dhe më ke shprehur dyshimin se mos Hysniun e kanë vranë. Të jam përgjigjur me këtë rast, duke u bazuar në shkencën mjekësore, se shkak u mikrobi i kancerit akoma nuk është zbuluar dhe ai nuk mund të inokulohet, ndryshe do t'i ishte gjendur ilaçi dhe, për t'ia arritur këtij qëllimi, po punojnë gjithë shkencëtarët e botës. Pra, faktet vërtetojnë se Hysniun ka pasur kancer dhe nuk mund të shpëtonte".

Në vjeshtë të vitit 1982, kur ndodhi kjo bisedë, që në virulencë të plotë shkatërrimi i të gjithë përkrahësve dhe pasuesve të quajtur prej Hoxhës si grupi tradhtar i bashkëpunëtorëve të poliagjentit Mehmet Shehu.


Për ta kryer këtë spastrim gjer në fund që montuar edhe ardhja në Shqipëri e një grupi të armatosur prej tre vetësh, me në krye Xhevdet Mustafën dhe në përbërje një informator të Sigurimit të Shtetit. Enver Hoxha e interpretoi këtë ngjarje si aksion për likuidimin e tij fizik dhe e deklaroi, si edhe

e shkroi në libër-kujtimet e tij, se gjithçka që vepër e Kadri Hazbiut, dorë e djathtë e Mehmet Shehut. Tek analiza dhe njëkohësisht akuzat politike kundër kryeministrit,

"Tabloja Sinoptike...", Hoxha pati ngulur këmbë fort se Shehu kishte marrë urdhër nga CIA dhe UDB që ta vrisnin nëpërmjet helmimit ushqimor. Në shtator 1982 ai me aksionin e Xhevdet Mustafës, të telekomanduar prej Sigurimit të Shtetit, donte të provonte para opinionit publik shqiptar, por edhe atij të huaj, aspak të bindur për çfarë pati ndodhur me kryeministrin shqiptar, se Kadri Hazbiu, i cili patjetër duhej hequr qafe dhe përfunduar në pranga, kishte vijuar planin vrasës së Mehmet Shehut, pra të agjenturës së huaj amerikano-jugosllave.

Me një zhvendosje zbarkimi nga pika e planifikuar, futur gabimisht në bregdetin e Divjakës në 25 shtator 1982, në datën njëzetë e shtatë Xhevdet Mustafa, në ndeshje me trupat e ushtrisë dhe të policisë, u vra në





Faksimile e letrës përcjellëse e Kujtim Hysenajt

Rrogozhinë, shumë larg Tiranës. Njëzetë e shtata është e njëjta ditë kur Enver Hoxha thirri dhe qortoi Vito Kapon, duke i lënë të qartë asaj të kuptonte se ato çaste me jo pak halle të tjera për të dhe regjimin, ngacmimi që i bënte fjalënajës për vdekjen me anë vrasjeje të të shoqit që i patolerueshëm.

Në ditarin e tij Hoxha nuk shënon orën kur regjistron lajmin e parë, thirrjen e Vito Kapos. Po ashtu nuk shënon edhe castin kur i mbërriti lajmi i likuidimit fizik të Xhevdet Mustafës. Për të me siguri nuk ka pasur ndonjë rëndësi cili që më i pari për peshën e vet në opinionin publik të vendit.

Por që të dyja, të bashkuara, qenë tepër. Enver Hoxha ishte i qartë se vrasja

det "kataliste" të opererëndimit, se një alternative e tillë nuk mbahej e hapur as në Beograd, por patjetër në Moskë. Njëkohësisht ai e dinte që ky plan në letër kurrë nuk u aktivizua për realizim konkret, prandaj edhe luante në propagandë sikur ato tentoheshin, por ai i bënte të dështonin. Prandaj edhe kur, kur kishte ndonjë nevojë politike, këto operacione agjenturore për vrasjen e tij i shpikte.

Vrasja propagandistike, ajo e sajuar, e një udhëheqësi shqiptar që monopol i Enver Hoxhës, spektakël ekskluziv për të. Sepse në fund të fundit kush synohej për likuidim fizik real konsiderohej element kyç i sistemit politik dhe shoqëror në Shqipëri dhe si i

pati shpëtuar Enver Hoxhën nga legjendarizimi që mund t'i ndodhte kryeministrit prej hovimit të ndonjë përfoljeje se këtij ia kishin marrë jetën agjencitë e huaja të spiunazhit. Kjo legjendë urbane do të buiste në pluralizmin e pas nëntëdhjetës, madje me të gjitha llojet e shkapërderdhjes së imagjinatës.

Sidoqoftë në dekadën e viteve tetëdhjetë ajo vdekje u ngurros në variantin zyrtar, i cili që edhe i vërtetë. Vrasja e vetes e deheroizante Shehun, ndërkaq që fjalënaja e nisur nga familja Kapo po tejheroizonte Hysni Kapon.

Gjallërimi i përfoljes se Kapo nuk pati ndërruar jetë natyrshëm, por për shkak të një komploti të kryer prej një aleançe duarsh bashkëpunuese nga brenda dhe jashtë, binte njëherësh ndesh jo vetëm me interesat e vazhdueshme të Enver Hoxhës për t'u vetëmitizuar, por ato çaste edhe me një frymë të përgjithshme mobilizimi të brendshëm të PPSH-së si parti-shtet për të dërmuar deri në fund çdo lidhje të mbetur prej ish-kryeministrit, këtij njeriu tashmë pa jetë, por me reputacion të pavdekshëm.

BASHKË ME VITO KAPON KËMBËNGUL EDHE XHELLI GJONI

Vito Kapo, edhe pse formalisht ra dakord me çfarë i tha Enver Hoxha, nuk u bind kurrë. Pas vitit 1991 ajo iu rikthye bërjes publike të dyshimeve dhe të akuzave të saj.

Kështu mund të thuhet se për dyzetë vite resht ajo vazhdon të mos heqë dorë prej ngritjes së gishtit kallëzues rreth ekzistencës së një plani konspirativ për likuidimin e shokut të saj të jetës.

Janë shumë të dyshuar prej saj. Fillojnë me grupin e mjekëve francezë, vijnë me Mehmet Shehun dhe Ramiz Alinë, po ashtu me Kadri Hazbiun apo Mihallaq Ziqishtin.

Prej një pjese të opinionit do të lexohej dhe interpretohej ky veprim i saj si dhimbje e përhershme dhe e natyrshme shpirtërore e një bashkëshorteje të devotshme, siç edhe Vito ka qenë dhe mbetet. Për të tjerë në gjallërimin e fjalëve të saj akuzuese gjatë vitit 1982 mund të ketë edhe një përpjekje për ta gjetur dorën e vdekjes së parakohshme të bashkëshortit të saj tek Mehmet Shehu dhe grupi i tij, ato kohë nën një goditje masive dhe ku ishte më e lehtë hedhja e fajit.

Do të kemi rastin në pjesët vazhduese të këtij shkrimi të interpretojmë si ndodhi që dosja mjekësore e Hysni Kapos më në fund, pas tri vitesh, u zhvendos prej arkivit të Ministrisë së Punëve të Jashtme në atë të Komitetit Qendror të PPSH-së.

Por këto çaste të vëzhgimit tonë rreth të vërtetës së mundshme rreth jetëhumbjes së udhëheqësit Hysni Kapo, duke arsyetuar se Vito në veprimin e saj ngulmues për të gjetur jo vdekjen natyrore prej një tumori në pankreas, por të një dore qëllimist vrasare, duke pasur forcë shtytëse edhe dhimbjen e paqetë njerëzore, gjithsesi kjo e fundit nuk rezultoi të jetë realisht faktori i parë.

Të paktën nuk e ka këtë status interpretues pas 4 prillit 2016, kur Xhelli Gjoni, përfaqësuesi tjetër me emër i familjes Kapo dhe person me vetëdijë të spikatur politike, rryfyes i shumë interesant i të kaluarës komuniste, pse jo edhe analist i qartë, i cili në gazetën "Panorama" deklaroi: "Nëse do të sjell në vëmendje një deklaratë të Nesti Nases, do të thosha se nuk përjashtohet dhe eliminimi i tij. Në gjyqin kundër Kadri Hazbiut, ish-ministri i Jashtëm, Nesti Nase tha se Andropovi,

kreu i KGB-së dhe ministër i Brendshëm i Bashkimit Sovjetik, i ishte shprehur se rruga për të eliminuar Enver Hoxhën ishte duke eliminuar Hysni Kapon. Nestin nuk e detyroi kush ta thoshte këtë deklaratë në gjyqin që i bëhej atij".

E kujtojmë një çast lexuesin se Nesi Nase ishte njeriu që për dy vite, deri sa u akuzua për tradhti dhe u hoq nga posti i Ministrit të Jashtëm, nuk e firmosi shkresën për dërgimin në Komitetin Qendror të PPSH-së (ku edhe e kishte vendin e duhur), të dosjes mjekësore të marrë në spitalin "Broussais" prej të Ngarkuarit me Punë të Ambasadës Shqiptare në Francë, Kujtim Hysenaj.

Në po të njëjtën intervistë Xhelli Gjoni, i pyetur mos mjekët francezë të "Broussais" qenë të kompromentuar nga agjenturat e huaja dhe vepronin nën porosinë e tyre, u shpreh tekstualisht: "Herën e dytë, shoku Enver dërgoi Ramiz Alinë në Paris që të qëndronte pranë Hysni Kapos. Por rezultoi se Ramizi mori vajzën e tij dhe nuk u mor fare me Hysniun. Por di që Hysni nuk e afroi fare, i qëndroi ftohtë".

I palëkundur që vdekja e udhëheqësit të njohur komunist është vepër e fshehtë dhe tinëzare e kryer në Tiranë dhe në Paris, Gjoni shtoi: "Hysni kishte kërkuar që të operohej në Shqipëri me Petrit Gaçen, por mjekët francezë këmbëngulën që ai të shkonte në Paris. Madje Petrit Gaçen e nxorën jashtë operacionit në Paris. Nuk të thonë gjë këto fakte ty?"

VDEKJA PROPAGANDISTIKE E HYSNI KAPOS SI VIKTIMIZIMI

Kur Enver Hoxha e thirri Vito Kapon dhe i thërhoqi rreptësisht vëmendjen që të mos përhapte fjalë se Hysni pati ndërruar jetë prej një vrasjeje politike, por nga një sëmundje kanceroze e pashërueshme, dosja mjekësore kishte mbërritur në zyrën e tij në Komitetin Qendror.

Ai e kishte parë imtësisht atë edhe kur hartoi letrën për të gjithë strukturën e partisë së vetme dhe të shtetit komunist me porosinë që të mos besonin aspak se Hysni Kapon e kishin vrasë spiunazhe të huaja dhe ca më tepër që viktimitë në një luftë të brendshme për pushtet.

Atij mund t'i pëlqente shumë që këtë hamendje të shprehur nga bashkëshortja e bashkëpunëtorit të tij të ngushtë ta përdorte për ta inkriminuar sa më shumë Mehmet Shehun. Megjithatë nuk e kreu. Hoxha me siguri atë kohë ka besuar se një përfolje e tillë e rëndonte shumë imazhin e tij dhe të PPSH-së dhe se pikërisht për këtë qëllim, shpjegimi se Hysni Kapo që vrasë i shërbente tërthorazi Beogradit, në mos e kishte njërin prej engejve shtypte këtë pikë gjeostrategjike antishqiptare në Ballkan. Doemos që rigjallërimi i herë pas herëshëm prej familjes Kapo i tezës se njeriu i dashur i tyre e ka humbur jetën nëpërmjet një atentati të sofistikuar hap shteg edhe dyshime të mëdha për rolin e vetë Enver Hoxhës në të gjithë këtë histori, çfarë do të thotë (pse jo?), gjithnjë sipas këtij qëndrimi këmbëngulës dhe asnjëherë të ndryshuar për katër dekada rresht, edhe pjesëmarrje e tij e qëllimshme në heqjen e çdo pengese për ta trashëguar postin e numrit një të Shqipërisë Ramiz Alia.

Kjo hipotezë, pra edhe prania konspirative e vetë Enver Hoxhës në vdekjen e Hysni Kapos, e shndërron ngjarjen, edhe pse në mënyrë disi të sforcuar, në njërin nga intrigat më të mëdha dhe më befaluese, prej më tronditëseve, të periudhës komuniste në Shqipëri.

Vec që kjo të bëhet një e vërtetë historike duhet shumë mund dokumentar, mjaft lëndë argumentuese dhe provuese, sepse ndryshe vdekja e Kapos ka gjasë të ngulitet në kujtesën kombëtare dhe në vetëdijën e shqiptarëve si një bluf ose, thënë më zbutur, si një shpërdorim tjetër politik i saj, si një manipulim dhe si krijim propagandistik për të fituar familjarisht, edhe kur nuk e kanë më themeluesin e tyre, porcione të tejmejdha të vëmendjes publike.

Ka po ashtu njëzë që mendojnë se një proces i tillë viktimizimi i Hysni Kapos kryhet për ta lehtësuar atë prej përgjegjësisë së një roli të ndjeshëm në diktaturë dhe me këtë rast, në doli të brezave pasues të familjes, për ta përshtratur dhe akomoduar atë me pluralizmin,

(Vijon)



Grupi i mjekëve pranë Hysni Kapos

më e parë dhe më e fundit që synonin të huajt, në Lindjen komuniste të ishin apo në Perëndimin antikomunist, që ai dhe vetëm ai. Madje Hoxha zotëronte mjaftueshëm informacion se planet për likuidimin e tij fizik nuk qenë në rend të dritës në SHBA apo tek ven-

tillë që tërësisht vetëm e vetëm ai. Shfaqja e domosdoshmërisë së vrasjes së një të dyti i pakësonte dritë dhe adhurim.

Vetëvrasja e Mehmet Shehut pothuaj një vit më parë se të thërriste Vito Kapon dhe niste letrën për informim të brendshëm, e

Zëvendësimi i gabuar i termit “togfjalësh” me



NGA ERGET CENOLLI

Terminologjia është një moment shumë i rëndësishëm në gjuhën shkencore. Nëpërmjet saj do të kuptojmë përmblendhaz natyrën e sendit apo dukurisë, përbërësit kryesorë, thelbin dhe dobinë e tyre. Në shkencën linguistike termi merr rëndësi më të madhe pasi gjuha është porta kryesore e komunikimit njerëzor.

Qysh herët, gramatikanët shqiptarë i vunë vetes qëllim që të krijonin një... gjuhë shkrimtore fillologjike...” thotë Xhuvani në shkrimin “Për themelimit të një gjuhe letrërore”, botuar në vitin 1905. Shkrimi i kësaj gjuhe “letrërore” kërkonte emërtimet e duhura, të cilat do të plotësonin detyrat e termit, por njëkohësisht do të ishin në përputhje me natyrën e gjuhës shqipe.

Një nga termat, që kanë goditur më tepër dhe më bukur në hartimin e ligjeve dhe rregullave shkencore të gramatikës sonë, është emërtimi “togfjalësh”.

“Togfjalëshi është njësi sintaktore strukturore e përfutur gjatë ligjërimit nga bashkimi gramatikor dhe kuptimor të bashkuara me lidhjen e nënrenditjes, që tregon marrëdhënie midis sendeve, dukurive, proceseve e tipareve. Fjalët që mund të bashkohen dhe formojnë togfjalësha, janë emrat, mbiemrat, përemrat, numërorët, foljet, ndajfoljet. Fjalët shërbyese, para-fjalët, lidhëzat janë krahas formave të fjalëve, mjete për bashkimin e fjalëve kuptimplota në togfjalësha”.

Siç shohim, në formimin e togfjalëve marrin pjesë të të klasa fjalësh, duke na dhënë një prej elementëve më të thelbësorë dhe më të përdorshëm të sintaksës së gjuhës shqipe.

Emërtimin togfjalësh e hasim herët në tekstet shkencore të

hartuara prej gramatikanëve më të spikatur shqiptarë. Mund të përmendim dy – tre shembuj për ilustrim: “Togfjalësha të qëndrueshëm foljorë në shqipen e sotme (sipas materialeve të të folmeve të Shqipërisë së mesme) prej Mehmet I. Çelikut në Buletin të Universitetit Shtetëror të Tiranës, viti 1962. “Shënime për fjalën dhe togfjalëshin” nga Xhevat lloshi në Studime mbi leksikonin dhe mbi formimin e fjalëve në gjuhën shqipe, Tiranë 1972. Nga vepra themelore e Shaban Demirajt “Gramatikë historike e gjuhës shqipe” shkëpusim: “11.Kurse në togfjalëshat e grupit të dytë përcaktori i paravendosur mund të jetë...” (faqe 550).

Togfjalëshat janë disa llojesh sipas fjalës bosht:

- Togfjalësha emërorë (baltë e kuqe);
- Togfjalësha foljorë (shkruaj letër);
- Togfjalësha mbiemërore (i ri nga mosha);
- Togfjalësha numërorë (tri nga vajzat);
- Togfjalësha përemërorë (secili nga ju);
- Togfjalësha ndajfoljorë (shumë mirë).
- (Vepër e cituar faqe 87)

Befas aty nga mesi i viteve '90 të shekullit të kaluar, në tekstet e gramatikës të të gjitha niveleve të arsimit parauniversitar, u shfaq dhe zuri vend termi “grup emëror”, i cili zëvendësoi me shpejtësi termin “togfjalësh”. U duk që në fillim që ishte një term kallp, i cili jo vetëm nuk është shqip, por

ç’është më e rëndësishmja, nuk i përgjigjet fare kuptimit logjik të konceptit që përfaqëson, Shkurt nëse do të citonim Sosyrin ishte një faktin se grupi emëror nuk i përgjigjet formës dhe përmbajtjes së togfjalëshit. Nëse nxënësit ia servirim, ashtu siç kemi bërë deri më sot, pra t’i themi grup emëror

mbiemëror, grup emëror ndajfoljor, foljor, përemëror etj., pa asnjë dyshim që po i themi keq dhe në mënyrë antishkencore, pasi fjala vjen togfjalëshi “secili prej jush” nuk ka asnjë emër. Pra ne çorjen-tojmë nxënësin duke e detyruar ta quajë grup emëror një “grup” i cili s’ka asnjë emër në përbërjen e tij. Në anën tjetër, edhe sikur ato

që thamë më lart të kishin ndonjë fije lidhjeje, përsëri është gabim i pafalshëm ndërrimi me “urdhërin e peshkut” të termit togfjalësh. Ky term është vendosur nga shkencëtarë të gjuhës shqipe si, Eqrem, Çabej, Shaban Demiraj, Mahir Domi, Mehmet Çeliku etj. dhe nuk mund të zëvendësohet nga kushdo. Atë që kanë bërë shkencëtarët nuk mund ta zhbëjë një dikush, i cili ka një diplomë mësuesie, mësuesi është për t’ua mësuar me lehtësi dhe thellësi nxënësvë, atë që shkencëtarët kanë zbuluar dhe emërtuar.

Si përfundim mendoj, se termi “grup emëror” (edhe termi tjetër gramatikorë), që ka hyrë në mënyrë të gabuar, në të gjithë hapësirën gramatike të arsimit parauniversitar, duhet zëvendësuar rrufeshëm në të gjitha tekstet shkollorë. Kështu do të zëvendësojmë me të drejtë një padrejtësi që po shtrembëron gramatikën e gjuhës shqipe, pasi kur vjen fjala për gabimet në gjuhë, Ferdinand de Sosyr na mëson se “... qëllimi i gjuhëtarit është që para së gjithash t’i denoncojë e shpërndajë sa më shumë që të jetë e mundur”.

“Gramatika e gjuhës shqipe 2 (Sintaksa)” botim i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe Letërsisë, Tiranë 2002



Gjuhëtarët

Ky term është vendosur nga shkencëtarë të gjuhës shqipe si, Eqrem, Çabej, Shaban Demiraj, Mahir Domi, Mehmet Çeliku etj. dhe nuk mund të zëvendësohet nga kushdo



Zëvendësimi

termi “grup emëror” që ka hyrë në mënyrë të gabuar, në të gjithë hapësirën gramatike të arsimit parauniversitar, duhet zëvendësuar rrufeshëm në të gjitha tekstet shkollorë



“Sonte do të luajmë pa tekst” në teatrën Kombëtar

Shfaqja me regji të Driada Dervishit, është duke përfunduar provat. Vjensi premierë në datat 20, 21, 22 Maj

Të luash një teatër brenda teatrit, kjo është gjetja më interesante e një dramaturgu të madh, por edhe e vështirë për t'u realizuar. “Sonte do të luajmë pa tekst”, drama e shkruar nga Luigi Pirandello vjen si premierë në Teatrën Kombëtar në datat 20, 21, 22 Maj, ora 19:00. Shfaqja me regji të Driada Dervishit, është duke përfunduar provat. Regjisorja rrëfen se pse zgjodhi pikërisht dramaturgun e njohur Pirandello. “Pirandello pavarësisht se është një nga dramaturgët le të themi që hyn tek ata më të vështirët, mënyra se si ai e percepton dhe të gjithë mënyrën e të shkruarit të tij është shumë afër dhe pranë jetës, është shumë afër njerëzores, është shumë afër dramave të njeriut të përditshmes dhe nga ana tjetër të dyja këto shkrihen bashkë me atë çka ndodh me realitetin në teatër”, shprehet Dervishi. Në dramën “Sonte do të luajmë pa tekst”, aktorët të njohur Dritan Boriçit i është besuar një kryerol, siç shprehet regjisorja, por jo më pak të



Driada Dervishit

rëndësishëm janë rolet që do të luhen nga aktorët Adelina Muca, Olta Daku, Met Xhelili, Sokol Angjeli, Niada Saliasi, Olta Gixhari, Amos Zaharia, Besmir Bitraku, Gent Hazizi, Neritan Licaj, Marsel Rupi. Në skenë do të ngjitet edhe koreografia e Elton Cefës me balerinët Elton Balla, Frenki Ziaj, Mateo Nushi, Evisa Lazri, etj. Drama e Pirandelos

zhvillohet edhe me pjesëmarrjen e Yllka Mujos. Driada Dervishi rrëfen rëndësinë e pjesëmarrjes së aktorese Yllka Mujo në premierën “Sonte do të luajmë pa tekst”. “Yllka është vërtet një fat, por nuk është vetëm një fat për mua që të jetë në stafin e kësaj trupe të madhe aktorësh, por është dhe një shembull për ata aktorë që do të vijnë të nesër-

me dhe në një farë mënyre për të treguar që disiplina artistike mund ta çojë përpara ndoshta edhe dëshirën e gjithë brezit të ri”, u shpreh Driada Dervishi. Regjisorja Dervishi është edhe autore e kësaj skenografie me detaje të kuruara me kujdes së bashku me Desantila Likën, ku kjo e fundit ka bërë edhe kostumet e aktorëve.

RILINDASI Sami Frashëri, intelektual i dy vendeve Shqipëri-Turqi

Një simpozium Ndërkombëtar kushtuar ideologut të rilindjes shqiptare Sami Frashërit dhe intelektualit që Turqia e konsideron më të madhin e vendit të saj është organizuar nga Universiteti i Tiranës, Universiteti i Trakias dhe Muzeu Historik Kombëtar. Akademikët të njohur të të dyja vendeve kanë folur për rolin që së figura e Sami Frashërit. Ndërsa akademikët turq e vlerësojnë Sami Frashërin si një nga figurat më të rëndësishme të kulturës së tyre kombëtare. Duke e njohur

me emrin Shemshedin Samiu, Turqia e ka çmuar për kontributin e pazëvendësueshëm për gjuhën dhe kulturën turke. Shteti turk nuk i ka pranuar asnjëherë kërkesat e qeverive shqiptare, që nga qeveria e Zogut për të kthyer eshtrat e Sami Frashërit në Shqipëri. Disa nga kontributet e Sami Frashërit që ligjëruan akademikët e Turqisë janë hartimi i fjalorit të turqishtes, fjalorin turqisht-frëngjisht dhe si autor i Fjalorit të madh enciklopedik “Kamus-al-alam”, me 6 vëllime e 4830 faqe.



Në fokusin e lexuesit online

[SHQIPTARJA.com]

LAJMET MË TË LEXUARA DJE

- Bashkëshortja e Salsanos publikon për HERË TË PARË foton e vajzës
- Blushi: Roshi më kërcënoi, debati pa mikrofon Blushi-Balla /VIDEO
- Skandali në Shkodër, djali i drejtoreshës abuzoi me fëmijët
- Bleona Cereci bën 'gabimin më të madh që një femër mund të bëjë'
- Denoncimi i Blushit, reagon Roshi: Ndjese për mesazhin e pahijshëm
- AMA dënon Ardit Gjëbrenë, ja pse
- "Drejtësia" PD sfidon SHBA-në kundër rikontrolit të pasurive
- Blushi: Elvis Roshi më kërcënoi ja mesazhi / Debate në Kuvend
- Skandali në Shkodër, abuzohen seksualisht 3 vajzat e jetimore
- VIDEO Një orë para se të zhdukej avioni i "EgyptAir" kaloi mbi Shqipëri

LAJMET MË TË KOMENTUARA

- "Baroni i drogës" PD: Kokëdhima emëroi Kelmend Baillajn me para
- Blushi: Roshi më kërcënoi, debati pa mikrofon Blushi-Balla /VIDEO
- Skandali në Shkodër, djali i drejtoreshës abuzoi me fëmijët
- Gjyqtari Qafa i bleu 'Gener 2' shtëpi 107 m2 për 40 mijë euro
- Padia e Fullanit, ekspertiza e psikologes: Dëmi i parikuperueshëm

VIDEOET MË TË KLIKUARA DJE

17-katëshi, edhe gjyqtari Qafa në konflikt interes, klienti "Gener 2"

Rama në Vlorë për Flamurtari- Skënderbeu, blinohet stadiumi


Isapo kthyer nga Gjermania prangoset për vjedhje Markelçani

Për të parë videon në smartphonin tuaj skanoni QR CODE me APP të REPORT TV që shkarkohet falas

SONDAZH I DITES

17-katëshi te diga, Gjyqtari i çështjes banon në pallatin e 'Gener 2', a ju duket normale që ai të gjykojë sot?

Rezultati i Sondazhit




SHËNIM:

Sondazhet online të Shqiptarja.com, nuk kanë vlerë statistikore. Bëhet fjalë për pyetje që u bëhen të gjithëve dhe jo kampionëve të përpunuar në mënyrë shkencore. Pra, kanë si qëllim të vetëm të lejojnë lexuesit të shprehin mendimin e tyre rreth temave të aktualitetit. Megjithatë, çdo lexues, mund të votojë vetëm një herë në ditë



1.671 | 276.035
KOMENTET E DJESHME | TOTALI LIKE



Pamje nga pestimet në Korçë



Champions, Skënderbeu sërish në vazoon e favoriteve

Edhe në edicionin e ri korçarët do të favorizohen nga shorti

Edhe në edicionin e ri të Champions League, Skënderbeu do të jetë në vazoon e skuadrave favorite. Nëse një vit më parë ekipi korçar ishte në anktin deri në përfundimin e të gjithë kampionateve nëpër Europë, për të siguruar praninë në vazoon e parë të turit të dytë kualifikues të Champions League, këtë vit janë të qetë sepse falë paraqitjeve shumë pozitive që kanë bërë në kompeticionet europiane gjatë sezoneve të fundit, tashmë kanë një koeficient shumë më të lartë në renditjen e UEFA-s për klube. Kampionët e Shqipërisë u pozicionuan kështu për të dytin vit radhazi në vazoon e skuadrave favorite, në ruandin e dytë paraeliminatory të Champions. Aktualisht Skënderbeu pozicionohet në vendin e 198 në klasifikim me 7825 pikë, koeficient ky që u jep të drejtën kampionëve të evitojnë një përballje të mundshme me shumë klube të mëdha europiane në turin e dytë kualifikues të Champions. Në këtë mënyrë në shortin që do të hidhet në Nyon të Zvicrës në datën 20 Qershor, kampionët e Shqipërisë do të

Goleadori

Korça feston titullin, Salihi "Këpuçën e Artë"



Stadioni i "Skënderbeu" është mbushur mbrrënyen e djeshme duke festuar fitimin e titullit kampion. Organizatorët e klubit ngritën një mini tribunë në qendër të fushës, duke ftuar personalitete nga bota e sportit, artit dhe politikës për të shprehur mendimet e tyre për fitoren e titullit nga skuadra. Ceremonia u zhvillua një ditë pas shpalljes kampion në Vlorë. Skënderbeu fitoi 2-0 ndaj Flamurtarit në ndeshjen e fundit të kampionatit dhe koleksionoi titullin e gjashtë radhazi dhe të 7-in në historinë e klubit. I pari që përshëndeti nga futbollistët ishte kapiteni Bledi Shkëmbi. Ndërsa Hamdi Salihi me 27 golat e shënuar prej tij, mori "Këpuçën e Artë" nga FSHF, bashkë me një çek prej 2 milionë lekë.

bëjnë pjesë në të njëjtën vazoon e klube të tilla si Red Bull Salzburg, Celtic Glasgoë, Apoel Nicosia, Bate Borisov, Legia e Varshavës, Dinamo e Zagrebit, Ludogorets, Fc Copenghagen,

Kundërshtarët

Vardari i Shkupit, Zrinjski Mostar, Norrköping, Ferencváros, Olimpja Podgorica, SJK, Dundalk, Liepaja apo edhe Crusaders


Shmangen

Nuk do kenë kundërshtarë: Red Bull Salzburg, Celtic Glasgoë, Apoel Nicosia, Bate Borisov, Legia e Varshavës, Dinamo e Zagrebit, Ludogorets, Fc Copenghagen, Qarabag etj

Qarabag etj. Për nga koeficienti Skënderbeu pozicionohet në vendin e 12-të teksa lë pas edhe një emër të madh si kampionia e Serbisë, Crvena Zvezda, dhe duke qenë se në vazoon e parë të turit të dytë do të bëjnë pjesë 17 skuadra, korçarët e kanë siguruar prezencën e tyre në të ashquajturën vazoon e skuadrave favorite. Në këtë mënyrë rriten ndjeshëm shanset e skuadrës së Mirel Josës për të kaluar sa më shumë raunde në Europë edhe gjatë këtij viti dhe ndoshta për të rishkruar historinë ashtu si një vit më parë. Kundërshtar i mundshëm për Skënderbeun në ruandin e dytë paraeliminatory të Uefa Champions League mund të jetë një prej 4 skuadrave që do të kualifikohen nga ruandi i parë por edhe ekipet të tilla si Vardari i Shkupit, Zrinjski Mostar, Norrköping, Ferencváros, Olimpja Ljubljana, Mladost Podgorica, SJK, Dundalk, Liepaja apo edhe Crusaders me të cilët Skënderbeu u ndesh edhe vitin e kaluar.

SERIE A

Juventus merr James nëse ikën Morata



Gazeta italiane "Corriere dello Sport" së fundmi ka raportuar për një interesim të Juventusit për mesfushorin kolumbian të Realit të Madridit, James Rodríguez. Në ditët e ardhshme do të ketë një takim mes drejtuesve të klubit spanjoll dhe atyre bardhezi për të diskutuar çështjen e sulmuesit Alvaro Morata. Po në këtë takim, Juventusit do të tentojë të bindë drejtuesit e Realit që të lejojnë transferimin e James në Torino. Mesfushori kolumbian nuk po kalon një moment të mirë në Madrid pasi në këtë sezon si me Benitez, ashtu edhe me Zidane në drejtim ka gjetur pak hapësira në formacionin titullar, ndaj ai po mendon largimin. Juventusit konsiderohet si një opsion i mirë për të vijuar karrierën nga ana e futbollistit kolumbian por pengesë në këtë operacion merkatit mund të bëhet shifra e lartë që kërkohet madrisht për James. Drejtuesit e Realit duan të përfitojnë mbi 70 milionë euro nga shitja e tij edhe pse tek Juventusit shpresojnë që gjithçka të mbyllet me sukses për një shumë jo më të lartë se 60 milionë euro.

VENDIMI I FSHF

Gjyqtar italian për finalen e Kupës së Shqipërisë

Finalja e Kupës së Shqipërisë do të drejtohet nga një gjyqtar italian. Kërkesa e Kukësit, që ndeshja e 22 Majit në "Qemal Stafa" të drejtohet nga një gjyqtar i huaj është miratuar. Madje, Federata Shqiptare e Futbollit pranoi edhe kushtin e vendosur nga klubi veri-lindor, që gjyqtari të mos ishte nga shtetet e rajonit, por të arbitronte në kampionatet e Europës Perëndimore. Emri i gjyqtarit që do të drejtojë në finalen e Kupës ndërmjet Kukësit dhe Laçit ende nuk është bërë publik, por për momentin dihet vetëm që ai është nga

vendi fqinj. Në orët në vazhdim Shoqata Italiane e Arbitrave do të konfirmojë në zyrat e FSHF-së edhe emrin e arbitrit kryesor dhe dy asistentëve. Sipas rregullores me kërkesën e bërë dhe pranimit e saj për gjyqtarë të huaj, të gjitha shpenzimet i faturon klubi të Kukësit. Bëhet fjalë për një kosto financiare në vlerën e 10 mijë eurove. Gjyqtarët italianë rikthehen pas 7 vitesh në aktivitetet tona kombëtare. I fundit ka qenë Gabriele Gava në Prill të 2009-ës, në gjysmëfinalen e Kupës Shkumbini-Flamurtari të mbyllur mes dhunës. Më parë, finalja

e Kupës në vitin 2006 ndërmjet Villaznisë dhe Tiranës ishte drejtuar nga Stefano Farina. E njëjta gjë ka ndodhur edhe në finalen e vitit 2003 ndërmjet Dinamos dhe Tiranës, ku kryesor ishte Alfredo Trentalanche, ndërsa në të njëjtin vit, italiani tjetër, Xhanluka Paparesta arbitroi sfidën play-off të kampionatit të 64-t ndërmjet Lushnjes dhe Apolonisë. Italiani i fundit që ka gjykuar në Shqipëri ishte Nikola Ricoli, që drejtoi ndeshjen e 8 Tetorit 2015 ndërmjet Shqipërisë dhe Serbisë, të vlefshme për kualifikueset e Euro 2016.





FJALËKRYQI PA SKEMË

DUHET TË NXINI 48 KUTI

17x17 crossword grid with numbers 1-17 in the first column.

HORIZONTAL

- 1. Janë qelqe.
2. Dësnuada dhe Vestida e Goya-s.
3. Gjysma e vlerës.
4. Janë vende ku prehen martirë.
5. Kështu fillon paniku.
6. Kush bën... ndëshkohet.
7. Bëri një pakt me djallin.
8. Stacion televiziv gjerman.
9. Një grup deputetësh.
10. Një grup deputetësh.
11. Janë piktorë si Edgar Degas.
12. Mirë në qendër.
13. Një dyqan me shumë tituj.
14. Para de Janeiro.
15. Inicialele e Seagat.
16. Kurrë në liall.
17. Mbyllin një dritare.
18. Kështu fillon qelqria.
19. Një serial në ekran.
20. Një... gjermane.
21. Ënte Industriale.
22. Një makinë me centrifugë.
23. Irlandë në Ulster.
24. Aiti i Horacit.
25. Janë vende si Katar.
26. Kërkojnë talent.
27. As unë as ti.
28. Ekstremitë në trup.
29. Qytet në Ruman.
30. Një është edhe atleti.
31. Eshhtë gabim trashkanik.

PËRGJIGJE E FJALËKRYQIT PA SKEMË

17x17 crossword grid with some letters filled in.

- 1. Janë në masë.
2. Të ve në një gatishmëri.
3. Terence aktor britanik.
4. Një material që shfrytëzohet për të shkuarar edhe monografi.
5. Veriu pa ekstremitë.
6. Një enë.
7. Janë të ndryshme në kapar.
8. Nasi shkrintar.
9. Miller që në dramaturg.
10. Eshhtë çmimi Oscar në francë.
11. Manaj të Inter.
12. Kun Agüero.
13. Eshhtë copë nga torta.
14. Mbetet në fund.
15. Behet mesim.
16. McBain shkrintar.
17. Janë antropofagje.
18. Janë ulëzime, në manual.
19. Fillojnë gjithmonë majtas.
20. Wertmüller regjisor.
21. Muzika e Eminem.
22. Eshhtë Çatia e Botës.
23. Saarinen që që arkitekt.
24. Inicialele e Frankenheimer regjisor.

FJALËKRYQI SPORTIV

17x17 crossword grid with numbers 1-17 in the first column.

PËRGJIGJE E FJALËKRYQIT SPORTIV

17x17 crossword grid with some letters filled in.

HORIZONTAL

- 1. Një mund të skadojë.
2. Ngriset në mbrëmje.
3. Kufizojnë katetet.
4. Eshhtë posta elektronike.
5. Personazhi në foto.
6. Një çiklist vetëm për velodrom.
7. Kërkon takent.
8. Inicialele e Morata-s.
9. Ngejshëre i mabjné sekretit trënerët.
10. Gjysma e datave.
11. Janë për të bërë slalom special.
12. Federer tenist.

- 25. Një pjesë e arumunëve.
26. Qendër ditore.
27. Gjysmë rekord.
28. Ritet pa ekstremitë.
29. Ekstremitë në ambiente.
30. Eshhtë ari i zi.
31. Personazhi në foto.
32. Malone që thirrej postier në NBA.
33. Eshhtë gara më e gjatë.

VERTIKAL

- 1. Thonë se është koha.
2. Termocentrali për shkurt.
3. Nelson portier brazilian.
4. Daga trainer.
5. Rrakli ish-bomber.
6. Kujtim ish-basketbollist.
7. Janë veshje sportive.
8. Nena e Ciceronit.
9. Faturë pa të.
10. Vucinic bomber malazez.
11. Një motoskat gare.
12. Pak idolatri.
13. Një vend që synohet nga kartelisti.
14. Emër vajze.
15. Angel di... mesfushr sergjenilinas.
16. Futboll i Holandës.
17. Një veshje balerinash.
18. Ruten në fund.
19. Një as brazilian.
20. Entë Lokale Mat.
21. Një Khan i ismailitëve.
22. Inicialele e Morata-s.
23. Ngejshëre i mabjné sekretit trënerët.
24. Gjysma e datave.
25. Janë për të bërë slalom special.
26. Federer tenist.

SUDOKU

PLOTESONI VENDET BOSH NË MËNYRË QË ÇDO RRESHT E KOLONË TË KETË NUMRAT NGA 1-9

9x9 Sudoku grid with some numbers filled in.

9x9 Sudoku grid with some numbers filled in.

HOROSKOPI

DASHI

Sot do jete ndjeshmeria juaj e tepruar ajo qe mund te sjelle probleme ne jeten tuaj ne çift. Mundohuni ta kontrolloni veten sepse ne te kundert do keni probleme serioze. Beqaret do jene me objektive se me pare dhe do maten disa here para se te hedhin hapa. Ne planin financiar duhet te merrni te gjitha masat e nevojshme ne menyre qe gjendja te mos ketë tronditje.

DEMI

Do jeni te parrezistueshem sot ju te dashuruarit sepse nuk është aspak koha e jashhtëzakonshme. Partneri do ju dashuroje me më tepër pasion se me pare dhe do ndiheni shpesh si mbire. Beqaret nuk do jene ne humorin e duhur për te filluar një lidhje, por njohje te reja do kenë. Ne planin financiar do jete Merkur i ai qe do ua qartësojë mendimet. Do dini si te veproni.

BINJAKËT

Dite shume pozitive do jete kjo e sotmja për ata qe janë ne një lidhje. Mund te mendoni ta çoni edhe me tej marrëdhënien tuaj dhe mund te planifikoni edhe pasardhësi. Beqaret ende nuk do jene gat te marrin vendime pasi kane frike mos humbasin lirinë qe kane. Ne planin financiar do fryje një fillad i lehte fati. Ka mundësi te arriji t'i zgjidhni problemet e vogla qe ju kishin dhale.

GAFORRJA

Nëse kohet e fundit e keni neglizhuar partnerin tuaj ne te mire te jetës profesionale, sot duhet pajtë të për kushtoheni me tëpër atij. Po e late ende pas dore mund ta humbni. Beqaret nuk do kenë asnjë takim ashtu si e kane ëndërruar dhe nuk do mund ta ndryshojnë dot statusin. Ne planin financiar mos u tregoni te paarsyeshëm sepse po filluan problemet zor se do dilni prej tyre.

LUANI

Marrëdhënia juaj me partnerin do për mirësohet tej mase sot. Do ja kaloni për mrekulli me partnerin dhe do përjetoni emocione te jashhtëzakonshme. Beqaret do veprojnë spontanisht dhe për fat do fillojnë një lidhje shume te vecante. Gjithcka për ta do jete e jashhtëzakonshme. Ne planin financiar nuk do keni asnjë lloj vështirësie kështu qe mund te kryeni pa frike shpenzimet e nevojshme.

VRGJËRESHA

Mos bëni asnjë lloj çmendurie sot ju te dashuruarit sepse nuk është aspak koha e duhur. Mire do jete ta merrni gjithcka me qetësi e maturi. Beqaret do kenë mundësi te jashhtëzakonshme për takime dhe duhet ta shfrytëzojnë ne maksimum secilin prej tyre. Financat do i menaxhoni me përkujdesi te madh dhe nuk do keni asnjë lloj tronditjeje. Vazhdoni kështu!

PESHORJA

Sot do merrni ne dore fatin e jetës tuaj ne çift dhe marrëdhënia do epe për mrekulli. Emocionet do jene te jashhtëzakonshme. Beqaret me mire t'i marrin gjerat shtruar dhe te mos kërkoni asgjë te menjëhershme. Do ndihen edhe me mire ashtu. Financat duhet t'i keni gjithë kohës ne qendër te vëmendjes pasi po filluan problemet vështirë se mund te zgjidhen shpejt.

AKREPI

Do keni mosmarrëveshje te njëpasnjëshme me partnerin tuaj gjate kësaj dite dhe nuk do ndiheni te qete për asnjë moment. Beqaret do kenë takime ne çdo moment te ditës dhe do arrijnë te bëjnë zgjedhjet e duhura. Mbrëmja do mbyllet me se miri për ta. Financat duhet t'i mbani gjithë kohës ne kontroll. Mos jepni as hua sepse do mbeteni keq për vete.

SHIGJETARI

Dite shume e qete ka për te qene kjo e sotmja për ata qe janë ne një lidhje. Do ndiheni gjithë kohës mire me atë qe keni ne krah dhe do dashuroheni pa dorashka. Beqaret nuk do duan te bëjnë ndryshime te statusit dhe do refuzojnë edhe disa mundësi te shkëlqera, për te cilat do pendohen shume shpejt. Me shpenzimet do bëni mire te jeni te kujdesshëm ne çdo cast.

BRICJAPI

Nëse tundoheni nga persona te trette sot, lidhja do filloje te ketë probleme serioze. Mundohuni te përqendroheni vetëm tek partneri juaj dhe te mendoni si ta bëni çdo cast emocionues. Beqaret do jene mijafit sharmante dhe kjo do i ndihmoje te joshin shume persona. Vazhdimësia do jete ne dorën e tyre. Ne planin financiar mos luani me zjarrin sepse keni për t'u dëgjur keq.

UJORI

Dite shume e paqëndrueshme ka për te qene kjo e sotmja për ata qe janë ne një lidhje. Do debatooni edhe kot se koti me atë qe keni ne krah. Ata qe janë vetëm do ndihmohen gjithë kohës nga Venusi dhe do realizojnë takime te jashhtëzakonshme. Buxheti do jete me i mire se kohet e fundit. Përfitoni për ta riorganizuar situatën dhe për te hequr disa para mënjane për te ardhmen.

PESHQIT

Dite e këndshme do jete kjo e sotmja për ata qe janë ne një lidhje. Do flisni hapur për çdo gjë me partnerin dhe kënaqësitë do jene te paimagjinueshme. Beqaret do preferojnë te qëndrojnë vetëm edhe për disa koha sepse ja kalojnë njëfarë mire me miqtë. Për buxhetin do kujdeseni gjithë kohës dhe për fat te mire nuk do ju dale asnjë lloj problemi ne këtë sektor.

PËRGJIGJE

17x17 crossword grid with some letters filled in.

SHKRONJA E NJËTË PËR NUMËR TË NJËTË

FJALËKRYQI I KRYPTOGRAFUAR

17x17 crossword grid with numbers 1-17 in the first column.



BUNK Jazz

Në atmosferën e ish superbunkerit antiatomik
tri netë të paharrueshme muzike Jazz që regjimi e ndalonte

E Premte 20 Maj ora 20:00 - 22:00
JAlbaniaZZ Society me **"Big Band"**

E premte 27 Maj ora 20:00 - 22:00
JAlbaniaZZ Society me **"Gent Rushi Quintet"**

E premte 3 Qershor
Lori's Quartet - ora 20:00 - 21:00
Gëzim Tivari Quartet - ora 21:00 - 22:00

Prezantuese:
Krist Ziçishti

Në BUNK'ART

Hyrja e lirë:
Jazz, swing-standart 50-70s,
jazz-funk, albanian jazz,
jazz '30-'40 avangard,
swing, funky, blues, latin.

Rr. Fadil Deliu (afër teleferikut) - Tiranë



www.bunkart.al / info@bunkart.al

Prenotime / Reservations: 068 48 34 444



Projekt i Mundësuar
nga Qendra Ura



Mbështetur nga
Bashkia Tiranë

